



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.172**

**dhjetor**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

|  |  |      |
|--|--|------|
| Akt normativ i KM<br>nr.5, datë 28.12.2011 | Për një ndryshim në ligjin nr.10 418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor” ..... | 9683 |
| Vendim i KM<br>nr.835, datë 30.11.2011     | Për miratimin e rregullores “Për kërkesat higjieno-sanitare të pishinave” .....  | 9683 |
| Vendim i KM<br>nr.870, datë 14.12.2011     | Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit.....  | 9712 |
| Vendim i ERRU<br>nr.28, datë 28.9.2011     | Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave.....  | 9715 |

**AKT NORMATIV  
Nr.5, datë 28.12.2011**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.10 418, DATË 21.4.2011 “PËR LEGALIZIMIN E  
KAPITALIT DHE FALJEN E NJË PJESE TË BORXHIT TATIMOR DHE DOGANOR”**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Në nenet 23 pika 1 shkronja “b”, dhe 35 të ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, data “... 31 dhjetor 2011 ...” zëvendësohet me “... 31 mars 2012 ...”.

**Neni 2**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Sali Berisha**

**VENDIM  
Nr.835, datë 30.11.2011**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KËRKESAT HIGJIENO-SANITARE TË  
PISHINAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.7643, datë 2.12.1992 “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror”, të ndryshuar dhe të pikës 4 të nenit 42 të ligjit nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e rregullores “Për kërkesat higjieno-sanitare të pishinave”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
  2. Rregullorja nr.4, datë 10.5.1989 e Ministrit të Shëndetësisë “Për kërkesat higjieno-sanitare të pishinave”, shfuqizohet.
  3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Sali Berisha**



**RREGULLORE**  
“PËR KËRKESAT HIGJIENO-SANITARE TË PISHINAVE”

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti dhe qëllimi**

Kjo rregullore përcakton kërkesat higjieno-sanitare, mjedisore, strukturore, teknike, menaxhuese dhe të sigurisë që duhet të plotësojnë pishinat publike dhe private me përdorim për not dhe argëtim me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së përdoruesve që lahen në to dhe të stafit të përfshirë në menaxhimin e tyre.

**Neni 2**  
**Përkufizime**

1. Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
- a) “Basen larje” është baseni artificial që furnizohet me ujë sipërfaqësor detar ose të ëmbël, të klasifikuar si ujë larës mbështetur në aktet ligjore në fuqi;
  - b) “Frekuentuesit” janë të gjithë përdoruesit që ndodhen në brendësi të zonës frekuentuese të pishinës;
  - c) “Kërkesa morfologjike” janë kërkesa që lidhen me formën dhe strukturën;
  - d) “Larësit” janë frekuentuesit që ndodhen në brendësi të zonës së larjes;
  - e) “Njësi banimi” është një pjesë e ndërtesës së banimit, e destinuar ose që është në pronësi individuale;
  - f) “Përdoruesit” janë përgjithësisht personat që hyjnë në kompleksin e pishinës, me përjashtim të punonjësve. Ata ndahen në “frekuentuesit”, “larësit” dhe “publiku”;
  - g) “Pishinë” është një kompleks i pajisur për larje dhe që ka një ose më shumë basene artificiale që përdoren për aktivitetet rekreativ, sportiv, mësimor dhe terapeutik që ushtrohet në ujin e këtyre baseneve;
  - h) “Pishinë për përdorim terapeutik” është pishina në të cilën zhvillohen aktivitete të kurimit dhe rehabilitimit;
  - i) “Pishinë termale” është pishina që përdor ujë termal, i përcaktuar si ujë natyral mineral që përdoret për qëllime terapeutike;
  - j) “Publiku” janë përdoruesit që ndodhen në brendësi të zonës për publikun;
  - k) “Rekreativ” janë aktivitete ose mjedise të cilat zhvillojnë aftësitë që ofrojnë nxitje, motivim dhe mënyrat e shpenzimit të kohës së lirë në mënyrë konstruktive për ripërtëritje fizike dhe shpirtërore, argëtim. Si të tilla, duhet të përfshijnë shumëllojshmëri të aktiviteteve: fizike, sociale, artistike dhe të të mësuarit;
  - l) “Riaftësim” është veprimi apo procesi i riaftësimit, që mund të jetë: a) riaftësim fizik i një të sëmuri apo personi me aftësi të kufizuara me anë të masave terapeutike dhe riedukimit për të marrë pjesë në aktivitetet e një jetë normale brenda kufizimeve të paaftësisë fizike të personit; b) riaftësim i një individi për një pozicion të dobishëm në shoqëri, veçanërisht përmes disa formave të rikualifikimit profesional, korrigjues apo terapeutik;
  - m) “Riedukim” është trajnimi për përdorim të muskujve në funksione të reja apo protezave me qëllim zëvendësimin apo kthimin e funksioneve të humbura; trajnimi për të zhvilluar sjellje të reja për të zëvendësuar sjellje të tjera që konsiderohen të padëshirueshme;

n) “Vaskë e pishinave” është një basen artificial, në të cilën uji përdoret për shumë periudha të aktivitetit, me rimbushje dhe boshatisje periodike;

### Neni 3

#### Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen vetëm për pishinat e kategorisë A, klasa A1, A2, A3, A4 dhe B, klasa B1, sipas nenit 5, dhe që kanë tipin a), b), c), d), e) dhe f) të vaskave, sipas nenit 7.

2. Përfshihen nga dispozitat e kësaj rregulloreje pishinat e klasifikuara në kategorinë B, klasa B/2, dhe në kategorinë C sipas nenit 5.

## KREU II

### KLASIFIKIMI I PISHINAVE

### Neni 4

#### Kriteri i klasifikimit

1. Për qëllime higjieno-sanitare pishinat klasifikohen në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- a) destinacionit dhe karakteristikave menaxhuese dhe të banimit;
- b) karakteristikave strukturore dhe mjedisore;
- c) llojit të përdorimit.

### Neni 5

#### Klasifikimi në bazë të destinacionit dhe karakteristikave menaxhuese dhe të banimit

1. Pishinat ndahen në kategoritë e mëposhtme:

- a) “Kategoria A”, pishina publike apo private, të destinuar për përdorim publik ose kolektiv;
- b) “Kategoria B”, pishina që u takojnë ndërtesave ose komplekseve të apartamenteve, të destinuar për t’u përdorur vetëm nga ata që qëndrojnë aty dhe të ftuarit e tyre;
- c) “Kategoria C”, pishina për përdorim terapeutik dhe pishinat termale.

2. Pishinat e kategorisë A ndahen në bazë të karakteristikave të menaxhimit, në grupet e mëposhtme:

- a) “Grupi A1”, pishina publike apo private të destinuar për përdorim publik;
- b) “Grupi A2”, pishina për përdorim kolektiv të përfshira në, ose jashtë strukturave të njëjësive akomoduese, si hotel, kompleks/fshat turistik, në dispozicion vetëm për banorët, si dhe të përfshira në struktura të tjera për përdorim kolektiv, si kolegjet, konviktet, shkollat, universitetet, qendrat komunitare, palestrat, sallonet e bukurisë dhe të aktiviteteve të ngjashme, klubet dhe shoqatat, në dispozicion të të ftuarve, studentëve, klientëve apo partnerëve;
- c) “Grupi A3”, pishina për lojërat në ujë;
- d) “Grupi A4”, struktura komplekse që përfshijnë pishina që u takojnë më shumë se një prej grupeve të mësipërme a), b) dhe c).

3. Pishinat e kategorisë B ndahen në bazë të numrit të njëjësive të banimit në grupet e mëposhtme:

- a) “Grupi B1”: pishina që u takojnë ndërtesave ose komplekseve të apartamenteve, të përbëra nga më shumë se katër njësi banimi;
- b) “Grupi B2”, pishina që u takojnë ndërtesave ose komplekseve të apartamenteve, të përbëra nga jo më shumë se katër njësi banimi;

4. Në pishinat e kategorisë C, në varësi të kufizimeve të përcaktuara me rregulla të veçanta, mund të kryhen aktivitete të tjera shtesë, si ato rekreative.



#### Neni 6

### **Klasifikimi në bazë të karakteristikave strukturore dhe mjedisore**

1. Në bazë të karakteristikave strukturore dhe mjedisore pishinat ndahen sipas tipave të mëposhtëm:

- a) “Tipi 1”, pishina të hapura, që përbëhen nga komplekse me një ose më shumë basene artificiale, jo të kufizuara brenda strukturës së mbyllur;
- b) “Tipi 2”, pishina të mbyllura që përbëhen nga komplekse me një ose më shumë basene artificiale të kufizuara brenda strukturës së mbyllur;
- c) “Tipi 3”, pishina e tipit të përzier, që përbëhen nga komplekse me një ose më shumë basene artificiale të hapura dhe të mbyllura që përdoren edhe njëkohësisht;
- d) “Tipi 4”, pishina të tipit të konvertueshëm, që përbëhen nga komplekse me një ose më shumë basene artificiale, në të cilat hapësirat e destinuara për aktivitet mund të jenë të hapura dhe të mbyllura në varësi të kushteve atmosferike.

#### Neni 7

### **Klasifikimi në bazë të përdorimit**

1. Në bazë të përdorimit të tyre, në varësi të tipit të pishinave, basenet ndahen në tipat e mëposhtëm:

- a) “Tipi A”, basenet për aktivitete noti, konkurruese dhe jokonkurruese dhe të stërvitjes;
- b) “Tipi B”, basenet për të gjitha aktivitetet e zhytjes dhe nënujore;
- c) “Tipi C”, basenet rekreative, të cilat kanë kërkesa morfologjike dhe funksionale që i bëjnë ato të përshtatshme për lojë dhe për larje;
- d) “Tipi D”, basenet rekreative për fëmijë me thellësi të njëjtë ose më të vogël se 60 cm, të cilat kanë kërkesa morfologjike dhe funksionale që i bëjnë ato të përshtatshme për fëmijët;
- e) “Tipi E”, basenet shumëfunksionale, të cilat kanë kërkesa morfologjike dhe funksionale që i bëjnë ato të përshtatshme për zhvillimin e njëkohshëm të aktiviteteve të ndryshme ose që plotësojnë kushtet e konvertimit që i bëjnë ato të përshtatshme për përdorime të ndryshme;
- f) “Tipi F”, basenet rekreative, të cilat karakterizohen nga prania e pajisjeve ndihmëse, si rrëshqitëset, sistemi i formimit të dallgëve apo funde të lëvizshme;
- g) “Tipi G”, basenet për përdorim terapeutik, që kanë kërkesa morfologjike dhe funksionale dhe pajisje të veçanta, që i bëjnë ato të përshtatshme për ushtrimin e aktiviteteve riaftësuese dhe riedukuese, nën kontrollin e specializuar mjekësor;
- h) “Tipi H”, basenet për përdorim kurativ dhe termal, në të cilat uji përdoret si mjet terapeutik në lidhje me karakteristikat fiziko-kimike të brendshme të tij dhe/ose mënyrën me të cilën vjen në kontakt me larësit dhe ushtrimi i këtyre aktiviteteve të larjes bëhet nën kontrollin e specializuar mjekësor.

### **KREU III KËRKESAT**

#### Neni 8

### **Kërkesat higjieno-sanitare dhe mjedisore**

Pishinat duhet të plotësojnë kërkesat higjieno-sanitare dhe mjedisore lidhur me karakteristikat e ujit që përdoret, lëndët që përdoren për trajtimin e ujit, pikat e marrjes së mostrave, kërkesat e temperaturës dhe lagështisë, ventilimit, ndriçimit dhe akustikës, të përcaktuara në shtojcën 1 dhe tabelën A.

#### Neni 9

### Zonat e mbrojtjes higjiëno-sanitare

1. Në lidhje me nivelet e ndryshme të mbrojtjes higjiëno-sanitare, në pishina dallohen zonat e mëposhtme:

a) “Zona për publikun”, e qasshme për përdoruesit në përgjithësi, pa asnjë pengesë të mbrojtjes sanitare;

b) “Zona e respektimit”, e destinuar për frekuentuesit dhe që ndan zonën për publikun nga zona për këmbë zbathur;

c) “Zona për këmbë zbathur”, e përshkueshme shpesh prej frekuentuesve dhe, si e tillë duhet që dyshemeja të ketë karakteristika që plotësojnë kërkesat për pastrim dhe dezinfektim të kollajshëm;

d) “Zona e larjes”, zona e seksionit të baseneve duke përfshirë vetë basenet dhe hapësirën përreth funksionale për aktivitetin e larjes;

e) “Zona frekuentuese” përbëhet nga tërësia e zonës për këmbë zbathur dhe zonës së respektimit;

f) “Solar”, zona e destinuar për qëndrim dhe ekspozim të mundshëm të frekuentuesve ndaj diellit, që ka kërkesat e zonës për këmbë zbathur.

2. Hyrja në zonën e respektimit lejohet vetëm me këpucë të pastra, të lashme dhe të dezinfektueshme ose me mbulesa këpucë të përshtatshme.

3. Zona për këmbë zbathur duhet të jetë e mbyllur dhe e arritshme vetëm nga zona e respektimit, pas larjes dhe dezinfektimit të këmbëve dhe këpucëve të destinuara për këtë zonë.

4. Hyrja në zonën e larjes lejohet vetëm pas pastrimit të plotë personal me anë të dushit.

#### Neni 10

### Kërkesat strukturore dhe të impianteve

1. Kërkesat strukturore dhe të impianteve të pishinës dhe të zonave përkatëse të instalimit duhet të përputhen me ato të përshkruara në shtojcën 9.

2. Pishina duhet të mbahet vazhdimisht në gjendje strukturore optimale, hapësirat dhe dhomat duhet të mbahen dhe përdoren vetëm për përdorimin për të cilin janë përcaktuar.

3. Seksioni i aktiviteteve ndihmëse duhet të jetë i vendosur në dhoma ose zona të ndara qartë nga seksioni i baseneve.

#### Neni 11

### Seksionet

1. Seksionet kryesore përbërëse të pishinës janë:

a) seksioni i baseneve që përfshin gjithë hapësirat që lidhen drejtpërdrejt me notimin dhe larjen;

b) seksioni i shërbimeve që përfshin të gjitha hapësirat e pajisura për zhveshjen, vendosjen e rrobave, shërbimet higjiënike dhe dushet, depozitimin e veglave, ndihmën e parë, stafin e instruktorëve, arbitrat dhe stafin e shërbimit;

c) seksioni i pajisjeve teknike që përfshin furnizimin me ujë dhe ngrohjen qendrore, impiantet e trajtimit të ujit, impiantet kundër zjarrit, impiantet për ngrohjen, ventilimin dhe kondicionimin e ajrit, impiantet e kullimit të ujit, impiantet e sigurisë dhe alarmit;

d) seksioni i publikut që përfshin të gjitha hapësirat për kalim, vendet për spektatorët, hapësirat ndihmëse, shërbimet higjiënike të rezervuara për spektatorët;

e) seksioni i aktiviteteve ndihmëse që përfshin hapësirat për aktivitete, duke përfshirë edhe ato sportive, përveç aktiviteteve të notit dhe larjes, si dhe aktiviteti i restorantit, barit, hapësira për aktivitete kulturele, mbledhje, zyra, salla e shtypit dhe aktivitete të tjera ndihmëse, sidoqoftë të njohura.

2. Prezenca dhe karakteristikat e këtyre seksioneve përcaktohen në lidhje me grupet e tipat e ndryshëm të pishinave dhe tipat e baseneve, siç tregohet në shtojcën 9.



## Neni 12 Ndhimja e parë

1. Pishinat duhet të jenë të pajisura me një sistem të organizuar të ndihmës së parë dhe rrugëve për qasjen e kollajshme për kryerjen e veprimeve që lidhen me të. Në çdo pishinë duhet të jenë të afishuara numrat telefonikë të urgjencës mjekësore, qendrës shëndetësore dhe spitalit më të afërt.

2. Pishinat e kategorisë A1, A3 dhe A4, duhet të jenë të pajisura me një dhomë të ndihmës së parë, e cila duhet të jetë qartësisht e dukshme dhe lehtësisht e arritshme.

3. Në dhomën e ndihmës së parë duhet të jenë gjithmonë të pranishme pajisjet dhe materialet terapeutike sipas shtojcës 9.

## KREU IV MODALITETI I PËRDORIMIT TË PISHINËS DHE PERSONELI

### Neni 13 Përdoruesit

1. Në çdo pishinë dhe në çdo moment, përgjegjësi i pishinës nuk duhet të lejojë futjen e një numri frekuentuesish më të madh se ai i lejuar për të siguruar funksionim të qetë dhe të rregullt të baseneve, të solarit, të dhomave të zhveshjes, dusheve dhe WC-ve, si dhe të çdo veprimtarie ndihmëse.

2. Në zonën frekuentuese nuk lejohet prania e një numri frekuentuesish më i lartë se sa maksimumi i lejuar. Për këtë qëllim, pishinat duhet të jenë të pajisura me sisteme apo procedura për të konstatuar arritjen e numrit maksimal të lejuar.

3. Numri i larësve duhet të jetë i tillë që të sigurojë që ngarkesa e ndotjes për shkak të aktiviteteve në ujë, në lidhje me vëllimin e ujit në basene, mbetet brenda kufijve të fuqisë së impianteve të trajtimit; duhet, gjithashtu, të sigurojë që veprimtaria e notit të zhvillohet në përputhje me kërkesat e sigurisë dhe të mbikëqyrjes së vetë larësve. Numri i lejuar i personave në zonën e larjes llogaritet në lidhje me llojet e ndryshme të baseneve sipas nenit 7, në bazë të parametrave të mëposhtëm:

- a) basene të tipit A: një person për çdo 2 metra katror të sipërfaqes së ujit;
- b) basene të tipit B, G dhe H: një person çdo 5 metra katror të sipërfaqes së ujit;
- c) basene të tipit C, D, E dhe F: një person çdo 3 metra katror të sipërfaqes së ujit.

### Neni 14 Përgjegjësi i pishinës

1. Administratori, me qëllim sigurimin e kërkesave të higjienës, sigurisë dhe të funksionalitetit të pishinës, emëron përgjegjësin e pishinës ose deklaron zyrtarisht marrjen përsipër të këtij funksioni.

2. Përgjegjësi i pishinës duhet:

a) të sigurojë funksionimin korrekt të strukturës në çdo aspekt menaxhues, teknologjik dhe organizativ;

b) të sigurojë zbatimin e kërkesave higjieno-sanitare dhe mjedisore të parashikuara nga legjislati në fuqi;

c) të sigurojë zbatimin e duhur të procedurave të kontrollit të brendshëm të përcaktuara në nenin 19;

d) të sigurojë pastrimin e përditshëm të të gjithë kompleksit të pishinës dhe dezinfektimin e rregullt.

## Neni 15 Personeli i pishinës

1. Administratori emëron profesionistët e mëposhtëm:
  - a) kujdestarin;
  - b) punonjësin për impiantet teknologjike.
2. Kujdestari është një person i kualifikuar dhe ngarkuar për vëzhgim, shpëtim dhe për dhënien e ndihmës së parë. Ai duhet të zotërojë dokumentin e aftësisë për not nga Federata Kombëtare e Notit, si dhe dokumentin e aftësisë për dhënien e ndihmës së parë nga Kryqi i Kuq Shqiptar ose Shërbimi i Urgjencës Mjekësore në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë.
3. Kujdestari, për qëllime të sigurisë, mbikëqyr aktivitetet që zhvillohen në basen dhe në zonën perimetrale rreth pishinës, si dhe respektimin e rregullores sipas nenit 16 për zonën që ka nën përgjegjësi.
4. Numri i kujdestarëve duhet të jetë i tillë që të sigurojë mbikëqyrje të njëkohshme dhe në mënyrë efikase në të gjitha basenet dhe përcaktohet nga përgjegjësi i pishinës në bazë të kriterit të pikës 5 dhe të dokumentit të vlerësimit të rrezikut (shtojca 5).
5. Numri minimal i kujdestarëve përcaktohet duke aplikuar raportin një kujdestar për çdo 350 m<sup>2</sup> sipërfaqe baseni. Në rastin e baseneve që ndodhen afër njëri-tjetrit dhe janë mjaft të dukshëm ndërmjet tyre, llogaritja bëhet në bazë të sipërfaqes shumatore. Prania e kujdestarëve duhet të sigurohet në vazhdimësi gjatë gjithë orarit të funksionimit të pishinës.
6. Funkzioni i kujdestarit mund të kryhet nga përgjegjësi i pishinës nëse plotëson kërkesat e pikës 2.
7. Në periudhën e përdorimit të baseneve për kurse trajnimi, trajnime sportive apo gara noti është e mjaftueshme prania e instruktorëve dhe/ose trajnerëve, me kusht që të plotësojnë kërkesat e pikës 2 dhe 5.
8. Për pishinat e grupit A2 dhe B1, nuk është e detyrueshme prania e kujdestarit, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
  - a) pishinë me basen me sipërfaqe deri në 180 m<sup>2</sup> me një thellësi deri në 150 cm e matur nga niveli i ujit;
  - b) pishinë me basen me sipërfaqe të çfarëdo përmase me thellësi deri në 120 cm e matur nga niveli i ujit;
  - c) mbikëqyrje e duhur;
  - d) prania e pajisjeve të shpëtimit në ujë, të tilla si jelekët: e shpëtimit, shkopa kapës të zgjatshëm dhe të tjera, të pranishme përreth basenit.
9. Për pishinat me përdorim kolektiv të përmendura në pikën 8, kur nuk parashikohet prania e kujdestarit, përgjegjësi i pishinës informon në mënyrën e duhur përdoruesit për mungesën e kujdestarit dhe pajis zonën e pishinës me mbrojtjen e duhur për ndalimin e hyrjes së pakontrolluar të personave nën moshën katërmëdhjetë vjeç me qëllim sigurinë e tyre. Detajet organizative të mbikëqyrjes dhe procedurave të ndërhyrjes duhet të tregohen në dokumentin e vlerësimit të rrezikut sipas shtojcës 5.
10. Punonjësi për impiantet teknologjike, në zotërim të aftësive të veçanta teknike, ka detyrë të sigurojë funksionimin korrekt të impianteve me qëllim respektimin e kërkesave higjieno-sanitare dhe mjedisore sipas nenit 8. Kjo detyrë mund të kryhet nga subjekte të licencuara nëpërmjet kontratave të veçanta.
11. Funksionet e përgjegjësit të impianteve teknologjike mund të kryhen nga vete përgjegjësi i pishinës.

## Neni 16 Rregullorja e brendshme

1. Përgjegjësi i pishinës përgatit një rregullore të brendshme për disiplinimin e raportit me përdoruesit në lidhje me aspektet higjieno-sanitare dhe të sigurisë.





2. Rregullorja e përmendur në pikën 1 të këtij neni përmban në veçanti elemente të edukimit shëndetësor dhe dikton kërkesat e higjienës personale dhe të sjelljes, të cilat kontribuojnë në mirëmbajtjen dhe sigurinë higjieno-sanitare të pishinës. Ajo përgjithësisht përmban:

- a) orarin e funksionimit të pishinës;
- b) kërkesat lidhur me shoqërimin e fëmijëve të mitur nga një person madhor;
- c) numrin maksimal të larësve dhe të frekuentuesve;
- d) kërkesat lidhur me higjienën dhe veshjet;
- e) ndalimin e zhytjeve në mungesë të strukturave të përshtatshme;
- i) treguesin e thellësisë dhe pikave të mundshme të vaskës me thellësi më të vogël;
- j) ndalimin e konsumimit të ushqimeve në zonën e larjes;
- k) këshilla të ndryshme lidhur me shëndetin dhe sigurinë;
- l) sinjalistikën për mungesën e kujdestarit sipas nenit 15, pika 9 etj.

3. Rregullorja e brendshme duhet të jetë e vendosur në një vend të dukshëm, në hyrje dhe në brendësi të pishinës, sipas mënyrës së përcaktuar nga përgjegjësi i pishinës, duke siguruar që njihet nga ana e përdoruesve.

4. Rregullorja e brendshme duhet të jetë shkruar në shqip dhe anglisht.

5. Një model-rregulloreje e brendshme jepet në shtojcën 10.

## KREU V KËRKESAT PËR FILLIMIN E AKTIVITETIT

### Neni 17

#### **Akti i miratimit higjieno-sanitar**

1. Pishinat e grupeve A1 dhe A4 fillojnë aktivitetin vetëm pas pajisjes me aktmiratim higjieno-sanitar nga strukturat lokale të shëndetit publik.

2. Për ristrukturimin apo zgjerimin e pishinave të grupeve A1 dhe A4, kur këto ndërhyrje sjellin ndryshime në planimetri dhe/ose funksion, është e detyrueshme pajisja me aktmiratim të ri higjieno-sanitar nga strukturat lokale të shëndetit publik.

3. Për pajisjen me aktmiratim higjieno-sanitar, aplikanti duhet të dorëzojë në strukturat lokale të shëndetit publik dokumentet e mëposhtme:

- a) njoftimin për fillimin e aktivitetit, sipas formularit në shtojcën 2;
- b) gjenplanin e vendosjes së strukturës;
- c) projektin e detajuar të strukturës;
- d) tipin e pishinës sipas klasifikimit referuar neneve 5 e 6;
- e) numrin dhe llojin e baseneve në përputhje me klasifikimin sipas nenit 7;
- f) burimin e furnizimit me ujë të pishinës;
- g) numrin maksimal të lejuar të frekuentuesve;
- h) identifikimin e përgjegjësit të pishinës sipas nenit 14 pika 1;
- i) dokumentacionin teknik që përshkruan tërë strukturën dhe impiantet e trajtimit të ujit, të ajrit, si dhe të çdo impianti tjetër si atyre të sigurimit, alarmit etj., sipas realizimit;
- j) deklarin e funksionimit vjetor apo sezonal, si dhe aktiviteteteve të mundshme me karakter privat apo manifestimeve të hapura për publikun.

4. Në rast të mangësive në dokumentacionin e paraqitur sipas pikës 3, struktura lokale e shëndetit publik i kërkon aplikantit plotësimet e nevojshme brenda 30 ditëve.

5. Struktura lokale e shëndetit publik verifikon pajtueshmërinë e aktivitetit me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe të akteve ligjore në fuqi dhe në rast pajtueshmërie, lëshon aktmiratimin higjieno-sanitar.

6. Në rast se nga verifikimi sipas pikës 5 rezulton mospajtueshmëri me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe/apo të akteve ligjore në fuqi, struktura lokale e shëndetit publik refuzon kërkesën për aktmiratim higjieno-sanitar.

7. Struktura lokale e shëndetit publik, Agjencia përkatëse e Ujit të baseneve dhe Agjencia Rajonale e Mjedisit informojnë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për aktmiratimet higjieno-sanitare, lejet e përdorimit të ujit, lejet mjedisore të lëshuara dhe për kërkesat e refuzuara.

#### Neni 18

### Njoftimi për fillimin e aktivitetit

1. Për fillimin e aktivitetit të pishinave të grupeve A2, A3 dhe B1, administratori njofton strukturat lokale të shëndetit publik, jo më pak se tridhjetë ditë përpara datës së fillimit të aktivitetit, sipas formularit në shtojcën 2.

2. Njoftimi sipas pikës 1, shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

- a) gentplani i vendosjes së strukturës;
- b) viti i ndërtimit;
- c) materialet e ndërtimit dhe përmasat e vaskave;
- d) mënyra e trajtimit të ujit të pishinës.

3. Në rast të ndryshimit të një ose më shumë elementeve të përmendura në pikën 2, administratori i pishinës është i detyruar të njoftojë strukturat lokale të shëndetit publik.

4. Administratori i pishinës me përdorim sezonal, tridhjetë ditë para datës së hapjes, bën një komunikim pranë strukturave lokale të shëndetit publik sipas formularit në shtojcën 3.

## KREU VI KONTROLLI

#### Neni 19

### Kontrolli i brendshëm

1. Përgjegjësi i pishinës realizon kontrollin e brendshëm, i cili ka për qëllim që nëpërmjet analizave dhe monitorimit të proceseve dhe të pikave kritike, të sigurojë respektimin e vazhdueshëm të kushteve higjieno-sanitare, mjedisore, strukturore dhe menaxhuese dhe të lejojë zbatimin e veprimeve korrigjuese të parashikuara, në mënyrë sa më të shpejtë dhe efektive.

2. Përgjegjësi i pishinës mban regjistrin e kontrolleve të ujit në basene, sipas shtojcës 7, që përmban:

- a) rezultatet e kontrollit (2 herë në ditë) të klorit aktiv të lirë, klorit aktiv të kombinuar, temperaturës, pH;
- b) sasinë dhe përshkrimin e produkteve të përdorura çdo ditë për dezinfektimin e ujit;
- c) datën e marrjes së mostrave për analizat e ujit;
- d) numrin e frekuentuesve të pishinës;
- e) rezultatet e kontrollit të përditshëm të mjedisave higjienike (dushe, WC, vaska për dezinfektimin e këmbëve, dhoma zhveshjeje).

3. Kontrollat e brendshme sipas pikës 1 kanë për qëllim vlerësimin e rrezikut në lidhje me çdo fazë të veprimtarisë.

4. Vlerësimi i rrezikut bëhet përpara fillimit të aktivitetit të pishinës, për çdo fillim sezoni, dhe jo më rrallë se një herë në 6 muaj dhe në çdo rast të ndryshimeve strukturore dhe, apo funksionale.

5. Dokumenti i vlerësimit të rrezikut përmban elementet sipas shtojcës 5.

6. Kur kontrollat e brendshme evidentojnë situata të rrezikshme për shëndetin publik, administratori merr masa për mbrojtjen e shëndetit, duke përfshirë mbylljen e të gjitha ose një pjese të pishinës dhe u komunikon menjëherë strukturave lokale të shëndetit publik natyrën e rrezikut dhe masat e marra.



7. Dokumentacioni sipas pikave të mësipërme duhet të jetë i përditësuar dhe mbahet në dispozicion të strukturave lokale të shëndetit publik/Inspektoratit Sanitar Shtetëror për një periudhë 3-vjeçare (trevjeçare).

#### Neni 20

### **Kontrolli i jashtëm**

1. Kontrolli i jashtëm është përgjegjësi e strukturave lokale të shëndetit publik/Inspektoratit Sanitar Shtetëror, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së elementeve funksionale dhe strukturore të pishinës me kërkesat higjieno-sanitare sipas kësaj rregulloreje.

2. Kontrolli kryhet në bazë të një programi inspektimi dhe ka si objekt:

a) verifikimin e dokumentacionit;

b) vlerësimin e zbatimit të kontrollit të brendshëm;

c) inspektimin higjieno-sanitar të të gjithë kompleksit të pishinës;

d) vlerësimin e cilësisë së ujit të pishinave nëpërmjet marrjes së mostrave dhe analizimit të tyre për tregues fiziko-kimikë dhe mikrobiologjikë;

3. Programi i inspektimit parashikon inspektimin me shpeshtësi si më poshtë:

a) për pishinat e hapura, para fillimit të sezonit dhe të paktën 1 herë gjatë sezonit;

b) për pishinat e mbyllura, 2-3 herë gjatë gjithë vitit;

4. Kontrolli i jashtëm kryhet sa herë është e nevojshme, si rezultat i ndodhjes së një ngjarjeje që ka nxjerrë në pah rreziqe potenciale për shëndetin apo sigurinë e përdoruesve të pishinës.

5. Analizat për kontrollin e jashtëm kryhen sipas kriterëve të përcaktuara në shtojcën 8.

6. Struktura lokale e shëndetit publik/Inspektorati Sanitar Shtetëror i dërgon me shkrim administratorit të pishinës rezultatet e inspektimit dhe të analizave.

7. Përgjegjësi i pishinës duhet të verë në dispozicion të strukturës lokale të shëndetit publik/Inspektoratit Sanitar Shtetëror dokumentet e mëposhtme:

a) aktmiratimin higjieno-sanitar;

b) regjistrin e kërkesave teknike dhe funksionale me të dhënat për përmasat dhe vëllimin e çdo baseni, numrin dhe llojin e filtrave, prurjen e pompave, sistemin e mirëmbajtjes etj., sipas shtojcës 6;

c) regjistrin e kontrolleve të ujit në basene;

d) dokumentin e vlerësimit të rrezikut;

e) dokumentacionin në lidhje me normativat për parandalimin e aksidentëve;

f) kopje të dokumenteve të aftësisë për kujdestarët;

8. Nëse nga inspektimi rezulton se pishina nuk i plotëson kërkesat higjieno-sanitare të parashikuara, autoritetet inspektuese lënë detyrat e nevojshme për plotësimin e këtyre kërkesave ose marrin masa administrative deri në mbylljen e pishinës.

9. Inspektorati Sanitar Shtetëror gjatë ushtrimit të kontrolleve për verifikimin e përputhshmërisë së elementeve funksionale dhe strukturore të pishinës me kërkesat higjieno-sanitare, sipas kësaj rregulloreje, bashkëpunon edhe me Agjencinë e Ujit të Basenit dhe Agjencinë Rajonale të Mjedisit.

#### Neni 21

### **Kundërvajtjet administrative**

Shkeljet e dispozitave të kësaj rregulloreje përbëjnë kundërvajtje administrative sanitare, për të cilat zbatohen dispozitat e ligjit nr.7643, datë 2.12.1992 “Për shëndetin publik dhe inspektoratin sanitar shtetëror”, të ndryshuar

KREU 7  
DISPOZITA KALIMTARE

Neni 22  
**Dispozita kalimtare**

1. Për pishinat që në datën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje janë në funksionim, administratori përcjell në strukturat lokale të shëndetit publik, brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, njoftimin për aktivitetin, sipas formatit në shtojcën 4, si dhe dokumentet sipas nenit 17, pika 3, gërmat “b” deri “j” për pajisjen me aktmiratim higjiëno-sanitar.

2. Pishinat ekzistuese që nuk kanë karakteristikat strukturore në përputhje me nenin 10, duhet të përshtatin këto karakteristika brenda një periudhe jo më shumë se pesë vjet nga hyrja në fuqi të kësaj rregulloreje. Administratori i pishinës paraqet në strukturat lokale të shëndetit publik planin e përshtatjes së bashku me komunikimin sipas pikës 1.

3. Në mungesë të plotësimit të kërkesave teknike sipas nenit 10 dhe deri në adaptimin e tyre, përputhshmëria e kërkesave strukturore dhe të impianteve me kërkesat higjiëno-sanitare dhe të sigurisë, si dhe përcaktimi i numrit maksimal të lejuar të frekuentuesve dhe numrit të kujdestarëve të notit përcaktohen nga administratori.

4. Përgjegjësit e pishinave ekzistuese përgatisin dokumentin e vlerësimit të rrezikut brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, në bazë të elementeve të listuara në shtojcën 5.

5. Përgjegjësit e pishinave janë të detyruar të respektojnë kërkesat e parashikuara për ujin e përdorur në to nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

SHTOJCA 1  
(Neni 8, pika 1 e rregullores)

1. Kërkesat higjiëno-sanitare dhe mjedisore

Kërkesat higjiëno-sanitare dhe mjedisore u referohen karakteristikave të ujit të përdorur në impiantin e pishinës, të kushteve termo-higrometrike, të ajrimit, ndriçimit dhe akustike.

**Klasifikimi dhe kërkesat e ujit të përdorur**

Ujërat që përdoren në impiant klasifikohen si më poshtë:

a) ujë i furnizimit: është uji i përdorur për furnizimin e baseneve (për rimbushje pas zbrazjes së plotë apo shtesë (i shtuar për mbajtje konstante të sasisë së tij)) dhe uji i përdorur për qëllime higjiëno-sanitare;

b) ujë që futet në basen: është uji i përbërë, si nga uji i riciklimit, ashtu edhe nga uji shtesë i trajtuar siç duhet për të plotësuar kërkesat e nevojshme;

c) ujë që ndodhet në basen: është uji që ndodhet në basenin e notit dhe, pra, në kontakt të drejtpërdrejtë me larësit.

**Kërkesat e ujit të furnizimit**

Uji i furnizimit duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e ujit të pijshëm të parashikuara nga aktet ligjore në fuqi, me përjashtim të temperaturës.

Nëse uji i furnizimit nuk sigurohet nga ndërmarrja e ujësjellësit, uji duhet të kontrollohet me shpeshësi sezonale, për parametrat e vlerësimit të përshtatshmërisë së ujit të pijshëm, të parashikuar nga aktet ligjore në fuqi.

**Kërkesat e ujit që futet në basen dhe të ujit që ndodhet në basen**

Uji që futet në basen dhe uji që ndodhet në basen duhet të plotësojnë kërkesat sipas tabelës A.

Kërkesat e cilësisë së ujit që ndodhet në basen duhet të plotësohen në çdo pikë.

Kontrolli i ujit që futet në basen kryhet sa herë që të jetë nevoja për auditim të brendshëm të menaxhimit ose për probleme që ndodhin.



Kërpuhat, myku dhe trihalometanet do të verifikohen me kërkesë të Institutit të Shëndetit Publik. Trihalometanet vlerësohen sipas kriterëve dhe parametrave të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

Metodat e analizave janë ato që përdoren për ujin e pijshëm. Për parametrat që nuk janë parashikuar për ujin e pijshëm, referimi u bëhet metodave të njohura të analizave.

Uji i basenit duhet të jetë plotësisht i rinovuar, pas zbrazjes, të paktën një herë në vit, por gjithmonë në çdo fillim të hapjes sezonale.

Nëse impianti është i pajisur me sistem të përshtatshëm për mbulim dhe mbrojtje gjatë periudhës së mbylljes, mund të mos bëhet rinovimi i plotë i ujit në basen. Në këtë rast, pronari i impiantit të notit parashikon një analizë të ujit në basen para hapjes së impiantit, por jo më shumë se 15 ditë nga hapja, me qëllim verifikimin e përshtatshmërisë së ujit në lidhje me parametrat e parashikuar në shtojcën 1. Rezultatet e këtyre analizave duhet të mbahen në dispozicion të Inspektoratit Sanitar Shtetëror.

Në tubacionin që furnizon ujin shtesë në çdo basen duhet të jetë instaluar një aparat matës.

#### **Lëndët për trajtimin e ujit**

Për trajtimin e ujit që futet në basen lejohet përdorimi i lëndëve të mëposhtme dezinfektuese, flokulante dhe korektuese të pH:

##### a) Dezinfektantë:

- ozon;
- klor i lëngshëm;
- hipoklorit natriumi;
- hipoklorit kalciumi;
- diklorizocianurat natriumi anhidër;
- diklorizocianurat natriumi dihidrat;
- acidi triklorizocianurik.

##### b) Flokulantë:

- sulfat alumini (i ngurtë);
- sulfat alumini (i lëngshëm);
- klorur ferrik;
- klorsulfat ferrik;
- polihidroksiklorur alumini;
- polihidroksiklorsulfat alumini;
- aluminat natriumi (i ngurtë);
- aluminat natriumi (i lëngët).

##### c) Korektues të pH:

- acid klorhidrik;
- acid sulfurik;
- hidroksid natriumi;
- bisulfat natriumi;
- bikarbonat natriumi.

Për dezinfektantët, flokulantët dhe korektuesit e pH pranohet e njëjta gradë pastërtie, si për lëndët që përdoren për trajtimin e ujit të pijshëm.

##### d) Lëndët antialge që mund të përdoren janë:

- klorur N-alkil-dimetil-benzil amoni;
- poli (hidroksietilen (dimetilimino) etilen (dimetilimino) metilen diklorur);
- poli (oksietilen (dimetilimino) etilen (dimetilimino) etilen diklorur).

Përdorimi i lëndëve që nuk janë përfshirë në këtë listë, duhet të jetë autorizuar paraprakisht nga Instituti i Shëndetit Publik.

TABELA A

| Parametri   | Ujë që futet në basen   | Ujë që ndodhet në basen   |
|---|---|---|
| <i>Kërkesa fizike</i>   |   |   |
| Temperatura:<br>- basen i mbyllur, në përgjithësi<br>- basen i mbyllur, për fëmijë<br>- basen i hapur                             | 24-32°C<br>26-35°C<br>18-30°C                                     | 24-30°C<br>26-32°C<br>---   |
| pH për dezinfektim me bazë klori<br>Kur përdoren dezinfektantë të tjerë, pH duhet të mbahet në vlerat optimale për dezinfektimin. | 6.5-8.5   | 6.5-8.5   |
| Turbullira në SiO <sub>2</sub>  | ≤2 mg/l SiO <sub>2</sub><br>(ose njësia ekuivalente e Formazinës) | ≤ 4mg/l SiO <sub>2</sub><br>(ose njësia ekuivalente e Formazinës) |
| Materialet e ngurta pezull  | ≤2 mg/l<br>(Filtrimi në membranë 0.45 µm)                         | ≤ 4mg/l<br>(Filtrimi në membranë 0.45 µm)                         |
| Materialet e ngurta të mëdha  | mungojnë  | mungojnë  |
| Ngjyra  | Vlera e ujit të pijshëm   | ≤ 5mg/l Pt/Co   |
| <i>Kërkesa kimike</i>   |   |   |
| Klori aktiv i lirë  | 0.6÷1.8 mg/l Cl <sub>2</sub> *)                                   | 0.7-1.5 mg/l Cl <sub>2</sub> *)                                   |
| Klori aktiv i kombinuar   | <0.2 mg/l Cl <sub>2</sub> *)                                      | <0.4 mg/l Cl <sub>2</sub> *)                                      |
| Përdorim i kombinuar<br>Ozon-klor:  |   |   |
| Klori aktiv i lirë  | 0.4-1.6 mg/l Cl <sub>2</sub> *)                                   | 0.4-1.0 mg/l Cl <sub>2</sub> *)                                   |
| Klori aktiv i kombinuar   | <0.05 mg/l Cl <sub>2</sub>  | <0.2 mg/l Cl <sub>2</sub>   |
| Ozon  | <0.01 mg/l O <sub>3</sub>   | <0.01 mg/l O <sub>3</sub>   |
| Acid izocianurik  | ≤75 mg/l  | ≤75 mg/l  |
| Ozon  | ≤0.03 mg/l O <sub>3</sub>   | të padallueshme   |
| Lëndë organike<br>(analizë me permaganat)   | ≤2 mg/l O <sub>2</sub>  | ≤2 mg/l O <sub>2</sub>  |
| Nitrate   | Vlera e ujit të pijshëm   | ≤20 mg/l NO <sub>3</sub>  |
| Flokulantë  | ≤0.2 mg/l Fe ose Al (lidhur me produktin e përdorur)              | ≤0.2 mg/l Fe ose Al (lidhur me produktin e përdorur)              |
| *) Në prezencë të acidit isocianurik të gjitha vlerat mund të rriten me 0.2 mg/l  |   |   |
| <i>Kërkesa mikrobiologjike</i>  |   |   |
| Escherichia coli  | 0 ufc/100 ml  | 0 ufc/100 ml  |
| Staphylococcus aureus   | 0 ufc/100 ml  | 0 ufc/100 ml  |
| Enterococchi  | 0 ufc/100 ml  | 0 ufc/100 ml  |
| Pseudomonas aeruginosa  | 0 ufc/100 ml  | 0 ufc/100 ml  |
| Llogaritja e kolonisë në 22 °C  | ≤100 ufc/ml   | ≤200 ufc/ml   |
| Llogaritja e kolonisë në 37 °C  | ≤10 ufc/ml  | ≤100 ufc/ml   |

#### Kërkesat termo-higrometrike dhe të ventilimit

Për pishinat e mbyllura, në seksionet e aktivitetit të notit dhe të larjes, temperatura e ajrit duhet të jetë jo më e ulët se temperatura e ujit në basen.

Lagështia relative e ajrit nuk duhet të kalojë në asnjë rast vlerën limit prej 70%. Shpejtësia e ajrit që i takon zonave të përdoruara nga frekuentuesit nuk duhet të jetë më e lartë se 0.10 m<sup>3</sup>/orë dhe duhet të sigurohet një ndryshim i ajrit të jashtëm me të paktën 20m<sup>3</sup>/orë për metër katror të basenit.

Në zonat e tjera për frekuentuesit (dhomat e zhveshjes, shërbimet higjienike, ndihma e parë), ndryshimi i ajrit duhet të jetë jo më pak se 4 volume/orë, temperatura e ajrit duhet të jetë jo më pak se 20°C.

#### Kërkesat e ndriçimit

Në seksionin e aktivitetit të notit dhe të larjes, ndriçimi artificial duhet të sigurojë kushte të tilla shikimi që të garantojë sigurinë e frekuentuesve dhe të kontrollit nga ana e personelit. Megjithatë, niveli i ndriçimit të dyshemesë dhe të sipërfaqes së ujit nuk duhet të jetë më pak se 150 lux.



Në zonat e tjera për frekuentuesit (dhomat e zhveshjes, shërbimet higjienike, ndihma e parë), ndriçimi artificial duhet të sigurojë një nivel mesatar të paktën 100 lux në dhomat e zhveshjes dhe 80 lux në shërbimet higjienike. Në të gjitha mjediset e ndriçuara në mënyrë natyrale, duhet të sigurohet një faktor mesatar ndriçimi jo më pak se 2%.

Duhet të parashikohet edhe impianti i ndriçimit në rast emergjence nga ndërprerja e mundshme e furnizimit me energji elektrike.

#### **Kërkesat akustike**

Në seksionin e aktivitetit të notit dhe të larjes së pishinave të mbyllura, koha e jehonës nuk duhet të jetë në asnjë pikë më e lartë se 1.6 sek. Kërkesat e akustikës pasive dhe zhurma e prodhuar nga aktiviteti duhet t'u referohen akteve ligjore në fuqi.

### SHTOJCA 2

#### FILLIMI I AKTIVITETIT

(Neni 17, pika 3; neni 18, pika 1 e rregullores)

Drejtuar ISSH të rrethit \_\_\_\_\_

Objekti: Fillim i aktivitetit për pishinë ndërtim i ri

KOMUNIKIM FILLIM AKTIVITETI:

PISHINË SIPAS NENIT 17 PIKA 1

PISHINË SIPAS NENIT 18 PIKA 1

VENDNDODHJA E IMPIANTIT TË NOTIT

Tel. \_\_\_\_\_ Faks \_\_\_\_\_

PRONARI I IMPIANTIT \_\_\_\_\_

VITI I FILLIMIT TË AKTIVITETIT \_\_\_\_\_

PERIUDHA E HAPJES \_\_\_\_\_

ORARI I HAPJES \_\_\_\_\_

PERSONELI I PISHINËS

PËRGJEGJËSI I PISHINËS

KUJDESTARËT

(neni 14, pika 1, germa "a") nr. \_\_\_\_\_

Emër, mbiemër \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

PUNONJËSIT E IMPIANTEVE TEKNOLOGJIKE

(neni 14, pika 1, germa "b") nr. \_\_\_\_\_

Emër, mbiemër \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

TIPI I PISHINËS NË BAZË TË DESTINACIONIT  
(neni 5, pika 1)

TIPI I PISHINËS NË BAZË TË KARAKTERISTIKAVE STRUKTURORE  
(neni 6)

TIPI I PISHINËS NË BAZË TË PËRDORIMIT  
(neni 7)

Numri i baseneve (specifiko numrin e përdorimitin e tyre) \_\_\_\_\_

PËRDORUESIT  
(neni 13)

Numri maksimal i lejuar i frekuentuesve \_\_\_\_\_

Numri maksimal i lejuar i larësve \_\_\_\_\_

TIPI I FURNIZIMIT ME UJË

a) nga rrjeti i ujësjellësit [ ]

b) nga pus apo burim [ ]

c) të tjera [ ] \_\_\_\_\_

Bashkëngjitur:

a) përdorshmëria;

b) relacion teknik përshkrues që përfshin: basenet, solarin, dhomat e zhveshjes për burra e gra, dushet dhe shërbimet higjienike për burra e gra dhe për invalidët, heqjen e pengesave arkitektonike, impiantin e trajtimit të ujit, dhomën e ndihmës së parë (nëse parashikohet);

c) pamje dhe planimetri;

d) raportanalizë që vërteton plotësimin e kërkesave të rregullores në rast të furnizimit me ujë nga burime private (pus apo burim) të një date jo më parë se 3 muaj, apo kontratën e furnizimit me ujë nga rrjeti i ujësjellësit;

e) kopje të dokumenteve të aftësisë për kujdestarët e notit, sipas nenit 15, pika 2;

f) relacion teknik lidhur me kërkesat sipas shtojcës 1, pikat 1.5, 1.6 e 1.7.

FIRMA E PRONARIT





**SHTOJCA 3**  
**RIHAPJA SEZONALE**  
(Neni 18, pika 4 e rregullores)

Drejtuar ISSH të rrethit \_\_\_\_\_

Objekti: Komunikim për rihapjen sezonale

**VENDNDODHJA E IMPIANTIT TË NOTIT**

Tel. \_\_\_\_\_ Faks \_\_\_\_\_

**PRONARI I IMPIANTIT** \_\_\_\_\_

**VITI I FILLIMIT TË AKTIVITETIT** \_\_\_\_\_

**PERIUDHA E HAPJES** \_\_\_\_\_

**ORARI I HAPJES** \_\_\_\_\_

**PERSONELI I PISHINËS**  
**PËRGJEGJËSI I PISHINËS**

**KUJDESTARËT**

(neni 15, pika 1, germa "a") nr. \_\_\_\_\_

Emër, mbiemër \_\_\_\_\_

**PUNONJËSIT E IMPIANTEVE TEKNOLOGJIKE**

(neni 15, pika 1, germa "b") nr. \_\_\_\_\_

Emër, mbiemër \_\_\_\_\_

**TIPI I PISHINËS NË BAZË TË DESTINACIONIT**

(neni 5, pika 1)

**TIPI I PISHINËS NË BAZË TË KARAKTERISTIKAVE STRUKTURORE**

(neni 6)

**TIPI I PISHINËS NË BAZË TË PËRDORIMIT**

(neni 7)

Bashkëngjitur:

- kopje e dokumenteve të aftësisë për kujdestarët e notit, sipas nenit 15, pika 2;
- dokumentacioni teknik përshkrues i strukturës, nëse janë bërë ndryshime strukturore në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar më parë në ISSH;
- dokumentacioni teknik përshkrues i impiantit të trajtimit nëse janë bërë ndryshime;
- deklarim i ndryshimeve të mundshme të impianteve (elektrike, termike, ajër i kondicionuar etj.);
- raportanalizë që vërteton plotësimin e kërkesave të rregullores në rast të furnizimit me ujë nga burime private (pus apo burim) të një date jo më parë se 3 muaj, apo kontratën e furnizimit me ujë nga rrjeti i ujësjellësit.

**FIRMA E PRONARIT**

SHTOJCA 4  
KOMUNIKIMI PËR PISHINAT EKZISTUESE  
(Neni 22, pika 1 e rregullores)

Drejtuar ISSH të rrethit \_\_\_\_\_

Objekti: Komunikim për pishinë ekzistuese

VENDNDODHJA E IMPIANTIT TË NOTIT

Tel. \_\_\_\_\_ Faks \_\_\_\_\_

PRONARI I IMPIANTIT \_\_\_\_\_

VITI I FILLIMIT TË AKTIVITETIT \_\_\_\_\_

PERIUDHA E HAPJES \_\_\_\_\_

ORARI I HAPJES \_\_\_\_\_

PERSONELI I PISHINËS  
PËRGJEGJËSI I PISHINËS

KUJDESTARËT

(neni 15, pika 1, germa "a")

nr. \_\_\_\_\_

Emër, mbiemër \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

PUNONJËSIT E IMPIANTEVE TEKNOLOGJIKE

(neni 15, pika 1, germa "b")

nr. \_\_\_\_\_

Emër, mbiemër \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

TIPI I PISHINËS NË BAZË TË DESTINACIONIT

(neni 5, pika 1)

TIPI I PISHINËS NË BAZË TË KARAKTERISTIKAVE STRUKTURORE

(neni 6)

TIPI I PISHINËS NË BAZË TË PËRDORIMIT

(neni 7)

Numri i baseneve (specifiko numrin e përdorimitin e tyre) \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



## PËRDORUESIT

(neni 13)

Numri maksimal i lejuar i frekuentuesve \_\_\_\_\_

Numri maksimal i lejuar i larësve \_\_\_\_\_

### TIPI I FURNIZIMIT ME UJË

a) nga rrjeti i ujësjellësit [ ]

b) nga pus apo burim [ ]

c) të tjera [ ] \_\_\_\_\_

### PLOTËSON KËRKESAT STRUKTURESIPAS RREGULLORES

PO [ ]

JO [ ]

Bashkëngjitur:

a) përdorshmëria;

b) relacion teknik përshkrues që përfshin: basenet, solarin, dhomat e zhveshjes për burra e gra, dushet dhe shërbimet higjienike për burra e gra dhe për invalidët, heqjen e pengesave arkitektonike, impiantin e trajtimit të ujit, dhomën e ndihmës së parë (nëse parashikohet);

c) pamje dhe planimetri;

d) raportanalizë që vërteton plotësimin e kërkesave të rregullores në rast të furnizimit me ujë nga burime private (pus apo burim) të një date jo më parë se 3 muaj, apo kontratën e furnizimit me ujë nga rrjeti i ujësjellësit;

e) kopje e dokumenteve të aftësisë për kujdestarët e notit, sipas nenit 15, pika 2;

f) relacion teknik lidhur me kërkesat sipas shtojcës 1, pikat 1.5, 1.6 e 1.7.

g) plan i përmbushjes së kërkesave strukturore nëse parashikohet.

FIRMA E PRONARIT

## SHTOJCA 5

### DOKUMENTI I VLERËSIMIT TË RREZIKUT NGA PËRGJEGJËSI I PISHINËS

(Neni 15, pikat 4 e 9; Neni 19, pika 5; Neni 22, pika 4 e Rregullores)

Në dokumentin e vlerësimit të rrezikut duhet të përmbahen të paktën elementet e mëposhtme:

1. Potenciale të rrezikshme higjieno-sanitare të përgjithshme

Përshkrimi i faktorëve biologjikë dhe kimiko-fizikë që mund të dëmtojnë shëndetin e përdoruesve të pishinës.

2. Potenciale të rrezikshme për sigurinë e përdoruesve

Përshkrimi i situatave që mund të paraqesin një rrezik për sigurinë e përdoruesve.

3. Fazat ose pikat kritike higjieno-sanitare dhe të sigurisë

Pikat dhe fazat në të cilat mund të verifikohen hazarse dhe/ose rreziqe sanitare, si për shembull:

- Uji i basenit;

- Hapësira perimetrale e basenit/kalimeve;

- Shërbimet higjienike, dushet, dhomat e zhveshjes;

- Mikroklima (për pishinat e mbyllura);

- Pajisjet (trampolinat, shkallët etj.);

- Impiantet (trajtimi i ujit-termik-elektrik-ajër i kondicionuar etj.);

- Produktet e përdoruara;

- Sjellja e përdoruesve dhe e personelit.

Masat parandaluese

4. Sistemi i monitorimit

Vëzhgimi, vlerësimi dhe/ose matje periodike të nevojshme për kontrollin e pikave kritike të identifikuara, sipas shpeshësisë dhe mënyrës së përcaktuar nga përgjegjësi i impiantit të notit.

5. Veprime korigjuese të parashikuara.

FIRMA E PËRGJEGJËSIT

**SHTOJCA 6**  
**REGJISTRI I KËRKESAVE TEKNIKO-FUNKSIONALE TË IMPIANTIT TË NOTIT NË**  
**KOMPETENCË TË PËRGJEGJËSIT TË PISHINËS**  
(Neni 20, pika 7, germa “b” e rregullores)

Muaji .....

BASENI \_\_\_\_\_

Sistemi i trajtimit të ujit \_\_\_\_\_

Sistemi i kontrollit: i automatizuar      Jo [ ]      Po [ ]      për parametrat

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Përmasat e basenit .....

Vëllimi i basenit .....

Numri i filtrave të basenit .....

Tipi i filtrave të basenit .....

Prurja e pompave .....

Sistemi i mirëmbajtjes .....

.....

.....

FIRMA E PËRGJEGJËSIT

**SHTOJCA 7**  
**REGJISTRI I KONTROLLIT NË BASEN NË KOMPETENCË TË PËRGJEGJËSIT TË**  
**PISHINËS**  
(Neni 19, pika 2 e rregullores)

Muaji ..... Viti .....

| Data | Parametrat e kontrollit të brendshëm |                  |             |    |                           |                     | Firma e përgjegjësit |
|------|--------------------------------------|------------------|-------------|----|---------------------------|---------------------|----------------------|
|      | Klor i lirë                          | Klor i kombinuar | temperatura | pH | Nr. ditor i frekuentuesve | Nr. ditor i larësve |                      |
| 1    |                                      |                  |             |    |                           |                     |                      |
| 2    |                                      |                  |             |    |                           |                     |                      |
| 3    |                                      |                  |             |    |                           |                     |                      |
| 4    |                                      |                  |             |    |                           |                     |                      |
| 5    |                                      |                  |             |    |                           |                     |                      |



|    |  |  |  |  |  |  |  |
|----|--|--|--|--|--|--|--|
| 6  |  |  |  |  |  |  |  |
| 7  |  |  |  |  |  |  |  |
| 8  |  |  |  |  |  |  |  |
| 9  |  |  |  |  |  |  |  |
| 10 |  |  |  |  |  |  |  |
| 11 |  |  |  |  |  |  |  |
| 12 |  |  |  |  |  |  |  |
| 13 |  |  |  |  |  |  |  |
| 14 |  |  |  |  |  |  |  |
| 15 |  |  |  |  |  |  |  |
| 16 |  |  |  |  |  |  |  |
| 17 |  |  |  |  |  |  |  |
| 18 |  |  |  |  |  |  |  |
| 19 |  |  |  |  |  |  |  |
| 20 |  |  |  |  |  |  |  |
| 21 |  |  |  |  |  |  |  |
| 22 |  |  |  |  |  |  |  |
| 23 |  |  |  |  |  |  |  |
| 24 |  |  |  |  |  |  |  |
| 25 |  |  |  |  |  |  |  |
| 26 |  |  |  |  |  |  |  |
| 27 |  |  |  |  |  |  |  |
| 28 |  |  |  |  |  |  |  |
| 29 |  |  |  |  |  |  |  |
| 30 |  |  |  |  |  |  |  |
| 31 |  |  |  |  |  |  |  |

**Lëndët e përdorura në mënyrë të përditshme për dezinfektim**

Lënda

Sasia

|       |       |
|-------|-------|
| _____ | _____ |
| _____ | _____ |
| _____ | _____ |
| _____ | _____ |

**SHTOJCA 8**

(Neni 20, pika 5 e rregullores)

**KONTROLLI ANALITIK NË KOMPETENCË TË INSPEKTORATIT SANITAR  
SHTETËROR**

**1. Marrja e mostrës dhe analiza e saj**

**1.1 Marrja e mostrës**

Marrja e mostrave bëhet sipas kërkesave minimale (shpeshhtësi, vendndodhje) të përcaktuara më poshtë.

Në momentin e marrjes së mostrës duhet t'i komunikohet përgjegjësit të pishinës dita, ora dhe vendi ku do të kryhet analiza. I interesuari apo personi i rekomanduar prej tij mund të jetë prezent në kryerjen e analizës, mundësisht i asistuar nga një konsulent teknik. Kostoja e kontrollit analitik mbulohet nga administratori i pishinës bazuar në tarifat e Institutit të Shëndetit Publik.

## 1.2 Pikat e marrjes së mostrës

Pikat e marrjes së mostrave

- Uji i furnizimit:

Mostra merret nga një rubinet i posaçëm në tubin e furnizimit.

- Uji që futet në basen:

Mostra merret nga rubineti në tubacionin e prurjes të çdo baseni poshtë impiantit të trajtimit.

- Uji që ndodhet në basen:

Mostra merret në një thellësi 20-40 cm në një pikë përfaqësuese të ujit në basen të paktën 40 cm nga anët e basenit.

### 1.2.1 Shpeshhtësia e marrjes së mostrës

Me përjashtim të situatave emergjente ose për verifikimin e rivendosjes së pajtueshmërisë të ujërave në fjalë, marrja e mostrave bëhet me shpeshhtësinë e mëposhtme:

- Uji i furnizimit: në rastin e përdorimit të ujit nga një burim privat, një herë në vit për pishinat e grupit A1, dhe sipas programeve të përcaktuara nga ISHP-ja për pishinat e grupeve të tjera;

- Uji që futet në basen: monitorimi do të kryhet sa herë është e nevojshme për të verifikuar funksionimin e impiantit të trajtimit;

- Uji që ndodhet në basen: shpeshhtësia përcaktohet në bazë të programeve të veçanta të të ISSH-së. Kjo përcaktohet në bazë të performancës nga inspektimet e kryera më parë nga ISSH-ja, nga karakteristikat e impiantit dhe shpeshhtësia e kontrolleve të brendshme.

### 1.2.2 Mënyra e marrjes së mostrës, transporti dhe ruajtja e mostrës

Marrja e mostrës për analiza mikrobiologjike kryhet sipas mënyrave të listuara në normën UNI 10637:2006 (Swimming Pools - Water quality and requirements for swimming pool water circulation, treatment and disinfection equipment) dhe rishikime të mëvonshme të mundshme. Në veçanti, për marrje të mostrave në basen, përdoren shishe sterile nga brenda dhe jashtë (të mbështjella) që në momentin e marrjes së mostrës duhet të hiqet dhe të kapet me një pincë sterile ose mjet tjetër të përshtatshëm.

Marrja e mostrës për analiza kimike kryhet sipas mënyrave të listuara në normën UNI 10637:2006 (Swimming pools - Water quality and requirements for swimming pool water circulation, treatment and disinfection equipment) dhe rishikime të mëvonshme të mundshme. Në veçanti, për marrje të mostrave në basen, përdoren enë të tipit sondë ose shishe normale qelqi apo plastike që duhet të futen kokëposhtë dhe të kthehen kokëlart vetëm në thellësinë e marrjes së mostrës.

Mostrat për analizë, pasi janë transportuar për në laborator në kohën më të shkurtër të mundshme, të mbrojtur nga drita, duke përdorur enë të izoluara dhe frigoriferike, për të siguruar që temperatura e ruajtjes së mostrave gjatë transportit nuk tejkalon atë të vërejtur në kohën e marrjes së mostrës.

Në rastet kur dorëzimi i mostrave në laborator nuk mund të bëhet menjëherë pas marrjes së mostrave, marrësi i mostrave siguron ruajtjen e tyre në një temperaturë prej 2-8 °C deri në mbërritjen në laborator, që sidoqoftë duhet të bëhet brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së mostrës.

### 1.3 Analizat e mostrës

Laboratori kryen analizat sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se brenda 24 orëve nga moment i marrjes së mostrës duke siguruar ruajtjen e mostrave në temperaturë 2-8 °C.

Analizat laboratorike dhe matjet në vend, me qëllim verifikimin e parametrave të përcaktuar në shtojcën 1, kryhen duke përdorur metodat e parashikuara për ujin e pijshëm.

Në mungesë të metodave të analizave dhe të aprovimit të tyre nga organi kompetent, matjet në vend dhe analizat laboratorike kryhen në bazë të metodave të zhvilluara/përdorura nga ISHP-ja mbi bazën e provave shkencore.

## SHTOJCA 9

### KËRKESAT STRUKTURE DHE TË IMPIANTEVE

(Neni 10, pika 1; neni 11, pika 2; neni 12, pika 3 të rregullores)

#### 1. Kërkesat strukturore dhe të impianteve



Kërkesat strukturore dhe të impianteve duhet të plotësohen, në veçanti që:

a) potenciali i impiantit të trajtimit të ujit të jetë proporcional me vëllimin e ujit që ndodhet në basen dhe me ndotjen mjedisore që shkaktohet nga përdorimi i tyre;

b) aktiviteti i notit zhvillohet në respektim të nevojave të sigurisë dhe mbikëqyrjes, në lidhje me format e veçanta dhe mënyrat e sjelljes të përcaktuara për secilën kategori dhe grup pishine dhe lloj vaske;

c) pastrimi i zakonshëm dhe i jashtëzakonshëm, përdorimi i dhomave të zhveshjes, dusheve, shërbimeve higjienike dhe i të gjitha hapësirave ndihmëse kryhet në mënyrë të rregullt dhe me rrezik minimal për sigurinë e frekuentuesve;

d) vendndodhja dhe instalimi i impianteve, si dhe menaxhimi i tyre janë të tilla që garantojnë sigurinë dhe qasje të lehtë.

## 2. Elementet funksionale të kompleksit të pishinës

Në kompleksin e pishinës, dallohen elementet funksionale të mundshme të mëposhtme, prezenca dhe karakteristikat e të cilave përcaktohen në lidhje me kategoritë dhe tipat e ndryshëm të pishinave dhe tipave të vaskave:

- Seksioni i aktivitetit të notit dhe të larjes;
- Seksioni i shërbimeve;
- Seksioni i impianteve teknike;
- Seksioni për publikun;
- Seksioni i aktiviteteve ndihmëse.

Në mjediset e zonave funksionale që lidhen me seksionin e aktivitetit të notit dhe të larjes, seksionin e shërbimeve, seksionin për publikun, seksionin e aktiviteteve ndihmëse, duhet të sigurohet shfrytëzimi nga ana e invalidëve, sipas normave në fuqi.

## KËRKESAT STRUKTURORE DHE TË IMPIANTEVE KATEGORIA A - GRUPET A1, A3 DHE A4

Në grupin A1 futen pishinat publike ose private të hapura për publikun.

Në grupin A3 futen impiantet e lojërave në ujë.

Në grupin A4 futen strukturat komplekse, që nënkupton pishinat që futen në më shumë se një nga grupet e kategorisë A.

## SEKSIONI I AKTIVITETIT TË NOTIT DHE TË LARJES

Për seksion të aktivitetit të notit dhe të larjes nënkuptohen tërësia e baseneve dhe hapësirave përkatëse drejtpërdrejt të lidhura me këto aktivitete dhe përfshin:

Basenet dhe hapësirat perimetrale rreth tyre, si dhe ato të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetet e notit dhe të larjes në mënyrë që të lejojnë qëndrimin e frekuentuesve.

Përveç respektimit të normave në fuqi sipas kërkesave teknologjike dhe të impianteve, strukturat që përbëjnë këtë seksion duhet të paraqesin karakteristikat e mëposhtme të përgjithshme:

### 1. Basenet

Planimetria e baseneve duhet të garantojë sigurinë e larësve, duke lejuar inspektim të lehtë me sy të të gjitha pjesëve të sipërfaqes ujore nga personeli përgjegjës për mbikëqyrjen dhe për të siguruar një qarkullim të plotë dhe uniform të ujit në të gjitha pjesët e saj.

Muret dhe tabani i baseneve duhet të jenë të veshura me material kundër rrëshqitjes, me ngjyrë të hapur.

Karakteristikat konstruktive të mureve të baseneve duhet të jenë të tilla që të mos përbëjnë rrezik për larësit. Në zonat me thellësi deri në 1,80 m, pjerrësia e tabanit nuk duhet të kalojë kufirin prej 8%.

Për të garantuar sigurinë e larësve gjerësia e hapjeve apo diametri i vrimave të mundshme në muret e basenit apo pjesë të tij, nuk duhet të jenë më të mëdha se 8 mm.

Trampolinat dhe platformat mund të instalohen vetëm në basene të cilat plotësojnë kërkesat sipas rregulloreve përkatëse në fuqi.

Muret perimetrale të lokaleve ku ndodhen basenet duhet të jenë prej materiali që lahet lehtësisht, i papërshkueshëm, kundër mykut, për një lartësi prej 2 m.

Për pishinat e mbyllura, lartësia e zonës së basenit, e matur nga niveli i lirë i ujit, duhet të jetë në çdo pikë jo më pak se 3.5 m.

Uji që ndodhet në basen gjatë operacioneve të qarkullimit dhe/ose zbrazjes së plotë, duhet të shkarkohet.

### **1.1 Sistemet e kapërderdhjes**

Të gjitha basenet duhet të jenë të pajisura me një sistem të përshtatshëm të kapërderdhjes sipas normave në fuqi.

Kanalet e kapërderdhjes dhe basenet duhet të jenë të veshura me materiale të papërshkueshme dhe të tilla që të lejojnë një pastrim të lehtë.

Ujërat e larjes së anëve të basenit nuk duhet të shkarkohen në kanalet e kapërderdhjes.

### **1.2 Shkallët dhe korimanot**

Kur thellësia e basenit kalon 60 cm duhen të parashikohen një ose më tepër shkallë apo këmbëshkallë të inkastruara në përputhje me formën dhe sipërfaqen e basenit.

Shkallët duhet të jenë prej materiali që i rezistojnë produkteve kimike që përdoren në pishina dhe duhet të jenë të pajisura me korimano të fiksuara mirë në strukturën e basenit.

Hapësira e lirë ndërmjet elementeve të shkallës dhe mureve të basenit nuk duhet të jetë më e vogël se 5 cm dhe më e madhe se 10 cm.

Fiksuesit për ndarësit e korsisë, si dhe çdo element tjetër fiksimi duhet të jenë të inkastruar në muret e basenit në mënyrë të tillë që të mos paraqesin rrezik për larësit.

### **1.3 Sinjalet**

Në anët e basenit duhet të vendosen sinjalet treguese për vlerat minimale dhe maksimale të thellësisë, si dhe duhet të evidentohen me anë të sinjaleve, kufijtë e ndryshimit të pjerrësive të tabanit.

### **2. Hapësirat perimetrale përreth baseneve (bankina perimetrale)**

Baseni duhet të jetë i rrethuar nga çdo anë prej një bankine perimetrale prej materiali jorrëshqitës për një gjerësi mundësisht deri në 2 m, por sidoqoftë jo më të vogël se 1.5 m dhe me pjerrësi jo më të madhe se 3%, për të mos lejuar qëndrimin e ujit. Ky ujë duhet të grumbullohet në sistemin e shkarkimit të ujërave të përdorura pa mundësinë e futjes së tyre në basen apo në sistemin e qarkullimit.

Të gjitha zonat ku mund të kalojë këmbëzbathur duhet të kenë sipërfaqe jo të rrëshqitshme.

### **3. Hapësirat e lidhura drejtpërdrejt me aktivitetin e notit dhe të larjes**

Ku parashikohen, hapësirat që lidhen me aktivitetet ndihmëse që praktikohen nga frekuentuesit, duhet të jenë të arritshme me këpucë të përshtatshme dhe të kenë karakteristika të përshtatshme higjieno-sanitare dhe mjedisore të tilla që të sigurojnë kushtet e pastërtisë, rehatisë dhe të sigurisë.

Në pishinat e mbyllura, hapësirat për qëndrimin e përdoruesve të impiantit të notit duhet të kenë përmasa të paktën 0.6 herë sipërfaqen e pasqyrës së ujit.

Në pishinat e hapura, hapësira për qëndrimin e përdoruesve (solari) duhet të ketë një sipërfaqe prej jo më të vogël se dy herë sipërfaqen e basenit.

### **4. Rrethimi i zonave të aktiviteteve**

Hapësirat perimetrale përreth basenit dhe ato që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e notit dhe të larjes duhet të jenë të rrethuara nga një strukturë e vazhduar (pengesë) e tillë që të lejojë kalimin në zonat fqinje të pashtruara vetëm nëpërmjet vendkalimeve.

Për këtë qëllim mund të përdoren shkurre, vazo me lule, gardhe, parmakë etj.

### **SEKSIONET E SHËRBIMIT**

Seksionet e shërbimit përfshijnë dhomat e veshjes dhe vendet e vendosjes së rrobave, dushet, WC, ndihma e parë dhe dhomat e personelit të shërbimit.





Të gjitha mobilet dhe pajisjet duhet të jenë lehtësisht të pastrueshme: materialet e përdorura duhet të jenë rezistente ndaj dezinfektantëve.

Nuk lejohen të dalat dhe tehet e mprehta që mund të përbëjnë një rrezik për sigurinë e frekuentuesve dhe të personelit, veçanërisht kujdes duhet t'u kushtohet zgjedhjes dhe vendosjes së pajisjeve dhe aksesorëve (radiatorëve, rubinetave të ujit, prizave elektrike, dorezave etj.).

Të gjitha dritaret duhet të jenë me qelq të sigurt, ose me materiale të tjera që në rast të dëmtimit nuk shkaktojnë dëme te personat. Ku është e nevojshme, prania e tyre duhet të vihet në dukje.

Dhomat e zhveshjes dhe tualetet duhet të kenë një lartësi minimale prej të paktën 2.4 m, me ventilim dhe ndriçim të përshtatshëm. Dyshemeja duhet të jetë prej materiali rezistent ndaj veprimit të dezinfektantëve në përdorim, i papërshkueshëm dhe i parrëshqitshëm, i pajisur me grilë shkarkimi për largimin e shpejtë të ujërave të pastrimit.

Dhomat e zhveshjes dhe tualetet duhet të jenë të ndara sipas gjinisë dhe të ndara në dy sektorë të veçantë, duke konsideruar një prani të barabartë të burrave dhe grave. Çdo sektor do të jetë i qasshëm edhe për personat me aftësi të kufizuara.

### **1. Dhomat e zhveshjes**

Dhomat e zhveshjes duhet të përbejnë elementin ndarës midis kalimit për këmbëveshur dhe kalimit për këmbëzbathur (ose me këpucë të destinuara veçanërisht për përdorim vetëm në zonat e aktivitetit të larjes).

Dhomat e zhveshjes mund të jenë të tipit me qarkullim, individuale ose kolektive.

Është i këshillueshëm përdorimi i dhomave të zhveshjes me qarkullim.

Kabinat e dhomave të zhveshjes me rrotullim duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:

i) Numri i tyre duhet të jetë jo më i vogël se 15% i numrit maksimal të përdoruesve minus numrin e dhomave personale dhe atyre kolektive kur këto janë prezent;

ii) Përmasat e dhomave të zhveshjes përcaktohen duke marrë në konsideratë një sipërfaqe minimale prej 1.6 m<sup>2</sup> për një vendzhveshjeje, duke përfshirë zonat e kalimit dhe hapësirën e varësive të rrobave apo rafteve të mundshme;

iii) Në kalimin me këmbë zbathur dhe para hyrjes për në basen duhet të sigurohet një hapësirë e përshtatshme për dorëzimin e rrobave;

iv) Duhet të jenë të pajisura me dy porta përballë njëra-tjetrës: njëra hapet në kalimin me këmbë veshur, tjetra në atë me këmbë zbathur;

v) Portat duhet të realizohen në mënyrë të tillë që në kabinat e lira të dyja të jenë gjithmonë të hapura, ndërsa në kabinat në përdorim të mbyllen nga brenda; duhet të jenë të pajisura me një sedilje portative dhe një pasqyrë; duhet të jenë prej materiali të lëmuar, rezistent dhe që pastrohet lehtë.

vi) Muret e kabinës duhet të kenë lartësi prej 2 m dhe një hapësirë të lirë nga dyshemeja të paktën 20 cm për të bërë të lehtë pastrimin dhe dezinfektimin, si dhe një hapësirë të lirë shtesë me tavanin;

vii) Të gjitha sipërfaqet vertikale dhe horizontale, si dhe ato që kanë qoshe të rrumbullakosura duhet të jenë ose të rivishen plotësisht me material që lahet lehtësisht, i papërshkueshëm dhe kundër mykut.

Në rastin e pishinave të pajisura edhe për zhvillimin e aktiviteteve të tjera përveç atij të larjes, dhomat e zhveshjes duhet të dallohen nga ato të aktiviteteve të tjera.

Në strukturat ekzistuese, në pamundësi strukturore për të ndarë kalimet, mund të përdoren mënyrat e organizimit, të cilat konsiderohen të përshtatshme, të prezantuara në rregulloren e brendshme.

### **2. Shërbimet higjienike**

Shërbimet higjienike ndahen proporcionalisht si më poshtë:

a) jo më pak se 4 WC për 20 dhomat e para të zhveshjes, të ndara në mënyrë të barabartë midis burrave dhe grave; numri i tyre duhet të rritet me nga 2 për çdo 20 dhoma shtesë ose fraksion të tyre; dhomat e WC-ve duhet të kenë dyer që hapen për nga jashtë.

Të paktën një dhomë zhveshjeje për çdo sektor për meshkuj dhe për femra duhet të jetë i shfrytëzueshëm nga personat me aftësi lëvizëse të kufizuara dhe/apo të dëmtuara.

b) jo më pak se një dush për çdo 4 poste zhveshjeje, të ndara në mënyrë të barabartë midis burrave dhe grave.

Në pishinat e mbyllura, zona e dusheve duhet të komunikojë me një hapësirë të ngrohtë dhe të pajisur me tharëse flokësh në një numër të barabartë me numrin e dusheve, ndërsa për ato të hapura duhet të parashikohet një numër minimal prej 2 tharëse flokësh për çdo zonë zhveshjeje.

Të paktën një dush për çdo sektor për meshkuj dhe për femra duhet të jetë i shfrytëzueshëm nga personat me aftësi lëvizëse të kufizuara dhe/apo të dëmtuara.

c) lavamanët ose pikat e furnizimit të ujit të pijshëm duhet të jenë në numër të përgjithshëm jo më të vogël se ai i WC-ve, të pajisur me shpërndarës të sapunit të lëngshëm ose pluhur dhe peshqir njëpërdorimësh. Megjithatë, në hapësirat antibanjo duhet të ketë të paktën një lavaman për çdo 2 WC.

#### 2.1 Shërbimet për personelin

Për përmasat e dhomave të zhveshjes dhe shërbimeve higjienike bëhet referimi në aktet ligjore në fuqi.

#### 2.2 Shërbimet për gjyqtarët e garës

Për shërbimet në dispozicion të gjyqtarëve të garës referimi bëhet në aktet ligjore në fuqi, në rast se impianti është i autorizuar për zhvillimin e garave sportive.

#### 3. Vendi për vendosjen e rrobave

Vendi për vendosjen e rrobave mund të realizohet, si me sistem individual, ashtu edhe me sistem kolektiv.

Në sistemin individual rrobat duhet të vendosen në raftë të mbyllshme, të pajisura me grila për ajrim, në lartësi nga dyshemeja të paktën 20 cm.

Në sistemin kolektiv rrobat duhet të vendosen në kontejnerë të veçantë dhe të dorëzohen në sportelin e dorëzimit dhe tërheqjes, e qasshme nga zona me këmbë zbatuar. Kontejnerët duhet të sistemohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë ruajtjen në kushte higjienike.

#### 4. Baseni i dezinfektimit të këmbëve të frekuentuesve

Qasja nga frekuentuesit e zonave të aktiviteteve të larjes duhet të jetë përmes një kalimi të detyrueshëm, përgjatë të cilit është vendosur një basen për larjen e këmbëve me dush, i pashmangshëm, i ushqyer në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar zëvendësimin siç duhet me ujë që përmban një lëndë dezinfektante.

Një vaskë e tillë, e pajisur me dush, duhet të ketë përmasa dhe strukturë të tillë që të bëjë të detyrueshëm zhytjen e plotë të këmbëve, duke përfshirë dhe këpucët, në lëndën dezinfektante, të arritshme edhe nga njerëzit me aftësi të kufizuara me pajisjet e tyre ndihmëse.

Për njerëzit me aftësitë lëvizëse të reduktuara dhe/ose të dëmtuara duhet të parashikohet në hyrje një sistem i përshtatshëm pastrimi që siguron pastrimin dhe dezinfektimin e rrotave të pajisjeve ndihmëse që përdoren prej tyre për të lëvizur.

#### 5. Dhoma e ndihmës së parë

Çdo pishinë duhet të pajiset me një dhomë të ndihmës së parë. Është e preferueshme që dhoma e ndihmës së parë të jetë në përdorim vetëm të pishinës: ajo duhet të përbëhet nga një vend që ka sipërfaqen dhe aksesin e duhur, e ajrosur dhe e ndriçuar siç duhet, e pajisur me lavaman me rubinet që nuk komandohet me dorë, me ujë të pijshëm.

Dhoma duhet të ketë shenja të qarta dhe të jetë lehtësisht e arritshme nga baseni dhe duhet të lejojë komunikimin e shpejtë dhe të lehtë me mjedisin e jashtëm përmes kalimeve që lehtësojnë kalimin e qetë të personelit të shërbimeve publike të emergjencës. Dhoma e ndihmës së parë duhet të jetë e pajisur me lidhje telefonike me jashtë dhe një tualet për përdorim vetëm me antibanjo.

Në rastin kur pishina ndodhet në brendësi të një strukture ku janë prezente edhe aktivitete të tjera, dhoma e ndihmës së parë mundet të jetë edhe në shërbim të këtyre aktiviteteve, për sa që sigurohet një akses i shpejtë dhe i qetë.



Dhoma duhet të ketë materialet e mjekimit dhe pajisjet për dhënien e ndihmës së parë si më poshtë:

- a) materialet e mjekimit;
- b) instrumentet për ndërhyrje të ndihmës së parë;
- c) Ambu;
- d) hapëse goje;
- e) bombol oksigjeni;
- f) mbulesë;
- g) aparat tensioni;
- h) tërheqëse gjuhe;
- i) kapëse për ndaljen e gjakut;
- j) shtrat mjekësor;
- k) barelë lugë.

#### **SEKSIONI I IMPIANTEVE TEKNIKE**

Seksioni i impianteve teknike përmban:

- sistemin e furnizimit me ujë dhe impiantin për trajtimin e ujit;
- sistemin termik;
- impiantin për prodhimin e ujit të ngrohtë;
- pajisjet dhe materialet për pastrimin dhe dezinfektimin;
- impiantin elektrik dhe telefonik;
- impiantin kundër zjarrit;
- impiantin e ngrohjes, të ajrimit dhe ajrit të kondicionuar;
- impiantin e komunikimit të brendshëm;
- impiantin e pastrimit dhe largimit të ujërave të përdorura;
- impiantin e sigurisë dhe të alarmit.

Të gjitha impiantet dhe aksesoret e tyre duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme nëpërmjet sinjaleve të posaçme që tregojnë funksionin e tyre.

Për sa është e mundur, duhet të përshtaten sisteme automatike të kontrollit dhe manovrimit të impianteve teknologjike.

Dhomat e destinuarat për aparaturat për trajtimin e ujit duhet që nga ana strukturore dhe ajo e funksionimit të jenë të ndara në dy dhoma: njëra për aparaturat e trajtimit të ujit dhe tjetra për vendosjen e kontejnerëve dhe të aparaturave përkatëse të dozimit të lëndës dezinfektante, të flokulantëve dhe të lëndëve shtesë. Këto dhoma duhet të kenë ajrim të përshtatshëm dhe të jenë të ndara nga sistemi termik. Në pamundësi të dyshemesë së papërshtatshme, këto dhoma duhet të kenë pjerrësinë e duhur që të sigurojnë dërgimin e rrjedhjeve të mundshme në një piletë grumbullimi.

Lartësia minimale e këtyre dhomave duhet të jetë jo më e vogël se 2.4 m. Në rastin e impianteve ekzistuese dhe në pamundësi të përshtatjes së lartësisë së dhomave, duhet të sigurohet një shkëmbim i përshtatshëm i ajrit edhe me ndihmën e impianteve të ajrimit mekanik.

Impiantet teknike (pompat, filtrat, sistemi i dezinfektimit, aparaturat matëse, basenet e kompensimit), qarkullimi, ndërrimi i plotë i ujit në basen duhet të jenë në përputhje me normat në fuqi.

#### **SEKSIONI PËR PUBLIKUN**

Me seksion për publikun nënkuptohen hapësirat e holleve, vendet për spektatorët, hapësirat ndihmëse, WC-të.

Kalimet e destinuarat për publikun duhet të jenë të ndryshme dhe të ndara nga ato të destinuarat për larësit.

Zonat e destinuarat për publikun duhet të respektojnë kërkesat e normave në fuqi në proporcion me numrin maksimal të lejuar të frekuentuesve.

Aty ku ka një seksion për publikun, vendet për spektatorët, hapësirat ndihmëse, shërbimet higjienike, hapësirat dhe kalimet e destinuarat për publikun, duhet të jenë të pavarura dhe të ndara nga ato

të destinuar për frekuentuesit e baseneve.

Në rastin e puqjes midis zonës së rezervuar për publikun dhe asaj të destinuar për frekuentuesit e baseneve, duhet të parashikohet një element ndarës me qëllim parandalimin e kalimit të pakontrolluar nëpërmjet dy zonave.

Është e nevojshme, gjithashtu, që të parandalohet që ujërat që dalin nga larja e sipërfaqeve të destinuar për publikun të rrjedhin drejt zonave që u takojnë frekuentuesve të baseneve. Për këtë qëllim duhet të përshtaten sisteme të përshtatshme të intersektimit (ulluqet, dysheme e pjerrët etj.) për të përcjellë dhe mbledhur ujin e larjes.

#### **SEKSIONI I AKTIVITETEVE NDIHMËSE**

Ku është parashikuar një seksion për shërbimet ndihmëse, si për shembull ato për aktivitete sportive të ndryshme nga ato të notit, hapësirat për freskim (bar, gatime të përgatitura dhe të ngrohta etj.), hapësirat për aktivitete argëtuese dhe kulturore, mjediset për zyrat dhe mbledhjet, salla e shtypit dhe aktivitete të tjera plotësuese, ky seksion duhet të jetë strukturuar për përdorim vetëm për publikun ose frekuentuesit e baseneve.

Janë të lejuara shërbime ndihmëse të përdorimit të përbashkët vetëm në rast se ka një ndarje të qartë midis sektorëve të përdorur nga të dyja kategoritë e përmendura më lart pa asnjë interferencë të kalimeve përkatëse.

### **KËRKESAT STRUKTURE DHE TË IMPIANTEVE**

#### **KATEGORIA A - GRUPI A2**

#### **KATEGORIA B - GRUPI B1**

Në grupin A2 dhe B1 futen impiantet e notit të përfshira në struktura të përdorura tashmë kryesisht për aktivitete të qasshme vetëm nga banorët, klientët, bashkëpunëtorët. Grupi A2 në veçanti përfshin pishina për përdorim kolektiv të përfshira në ose jashtë strukturave të njëjësive akomoduese, si: hotel, kompleks/fshat turistik në dispozicion vetëm për banorët, si dhe të përfshira në struktura të tjera për përdorim kolektiv, si: kolegjet, konviktet, shkollat, universitetet, qendrat komunitare, palestrat, sallonet e bukurisë dhe të aktiviteteve të ngjashme, klubet dhe shoqatat, në dispozicion të të ftuarve, studentëve, klientëve apo bashkëpunëtorëve.

Grupi B1 përfshin pishina që bëjnë pjesë në grup banesash me më shumë se katër njësi banimi.

#### **SEKSIONI I AKTIVITETIT TE NOTIT DHE TE LARJES**

Për seksion të aktivitetit të notit dhe të larjes nënkuptohen tërësia e baseneve dhe hapësirave përkatëse drejtpërdrejt të lidhura me këto aktivitete dhe përfshin:

basenet dhe hapësirat perimetrale rreth tyre, si dhe ato të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetet e notit dhe të larjes në mënyrë që të lejojë qëndrimin e frekuentuesve.

Përveç respektimit të normave në fuqi sipas kërkesave teknologjike dhe të impianteve, strukturat që përbëjnë këtë seksion duhet të paraqesin karakteristikat e mëposhtme të përgjithshme:

##### **1. Basenet**

Planimetria e baseneve duhet të garantojë sigurinë e larësve, duke lejuar inspektim të lehtë me sy të të gjitha pjesëve të sipërfaqes ujore nga personeli përgjegjës për mbikëqyrjen dhe për të siguruar një qarkullim të plotë dhe uniform të ujit në të gjitha pjesët e saj.

Muret dhe tabani i baseneve duhet të jenë të veshura me material kundër rrëshqitjes, me ngjyrë të hapur.

Karakteristikat konstruktive të mureve të baseneve duhet të jenë të tilla që të mos përbëjnë rrezik për larësit. Në zonat me thellësi deri në 1,80 m, pjerrësia e tabanit nuk duhet të kalojë kufirin prej 8%.

Për të garantuar sigurinë e larësve gjerësia e hapjeve apo diametri i vrimave të mundshme në muret e basenit apo pjesë të tij, nuk duhet të jenë më të mëdha se 8 mm.



Trampolinat dhe platformat mund të instalohen vetëm në basene të cilat plotësojnë kërkesat sipas rregulloreve përkatëse në fuqi.

Muret perimetrale të lokaleve ku ndodhen basenet duhet të jenë prej materiali që lahet lehtësisht, i papërshkueshëm, kundër mykut, për një lartësi prej 2 m.

Për pishinat e mbyllura, lartësia e zonës së basenit, e matur nga niveli i lirë i ujit, duhet të jetë në çdo pikë jo më pak se 3.5 m.

Uji që ndodhet në basen gjatë operacioneve të qarkullimit dhe/ose zbrasjes së plotë, duhet të shkarkohet ose të ripërdoret në përputhje me kërkesat e akteve ligjore në fuqi.

#### 1.1 Sistemet e kapërderdhjes

Me ujë të kapërderdhur nënkuptohet uji i grumbulluar nga shkarkime të pavarura nga ndryshimi i nivelit për shkak të pranisë së larësve, por për shkak të riqarkullimit, rimbushjes dhe faktorëve natyrorë aksidentalë (shi, erë etj.)

Të gjitha basenet duhet të jenë të pajisura me një sistem të përshtatshëm të kapërderdhjes, si kanale shkarkuese perimetrale, skimera të fiksuar në mure në nivelin e sipërfaqes së ujit.

Në basenet për notarët, skimerat nuk duhet të instalohen në muret e kthimit.

Kanalet e kapërderdhjes dhe basenet duhet të jenë të veshura me materiale të papërshkueshme dhe të tilla që të lejojnë një pastrim të lehtë.

Ujërat e larjes së anëve të basenit nuk duhet të shkarkohen në kanalet e kapërderdhjes.

#### 1.2 Shkallët dhe korimanot

Kur thellësia e basenit kalon 60 cm duhen të parashikohen një ose më tepër shkallë apo këmbëshkallë të inkastruara në përputhje me formën dhe sipërfaqen e basenit.

Shkallët duhet të jenë prej materiali që i rezistojnë produkteve kimike që përdoren në pishina dhe duhet të jenë të pajisura me korimano të fiksuar mirë në strukturën e basenit.

Hapësira e lirë ndërmjet elementeve të shkallës dhe mureve të basenit nuk duhet të jetë më e vogël se 5 cm dhe më e madhe se 10 cm.

Fiksuesit për ndarësit e korsisë, si dhe çdo element tjetër fiksimi duhet të jenë të inkastruar në muret e basenit në mënyrë të tillë që të mos paraqesin rrezik për larësit.

#### 1.3 Sinjalet

Në anët e basenit duhet të vendosen sinjalet treguese për vlerat minimale dhe maksimale të thellësisë, si dhe duhet të evidentohen me anë të sinjaleve, kufijtë e ndryshimit të pjerrësive të tabanit.

#### 2. Hapësirat perimetrale

Baseni duhet të jetë i rrethuar nga çdo anë prej një bankine perimetrale prej materiali jorrëshqitës për një gjerësi mundësisht deri në 2 m, por sidoqoftë jo më të vogël se 1.5 m dhe me pjerrësi jo më të madhe se 3%, për të mos lejuar qëndrimin e ujit. Ky ujë duhet të grumbullohet në sistemin e shkarkimit të ujërave të përdorura pa mundësinë e futjes së tyre në basen apo në sistemin e qarkullimit.

Të gjitha zonat ku mund të kalohet këmbëzbathur duhet të kenë sipërfaqe jo të rrëshqitshme.

Hapësirat perimetrale përreth basenit dhe ato që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e notit dhe të larjes duhet të jenë të rrethuara nga një strukturë e vazhduar (pengesë) e tillë që të lejojë kalimin në zonat fqinje të pashtuara vetëm nëpërmjet vendkalimeve.

Për këtë qëllim mund të përdoren shkurre, vazo me lule, gardhe, parmakë etj.

#### SEKSIONET E SHËRBIMIT

Seksionet e shërbimit përfshijnë dhomat e veshjes dhe vendet e vendosjes së rrobave, dushet, WC-të, ndihma e parë dhe dhomat e personelit të shërbimit.

#### 1. Dhomat e zhveshjes dhe shërbimet higjienike

Në pishinat e grupit A2 në shërbim të objekteve turistike-akomoduese hoteliere dhe ekstrahoteliere, meqenëse hyrja në pishinë rezervohet vetëm për të ftuarit, nuk janë të detyrueshme dhomat e zhveshjes, as shërbimet higjienike në brendësi të impiantit të notit.

Për pishinat e grupit A2, të përfshira në strukturat e caktuara për përdorim kolektiv, si: shkollat,

klubet, shoqatat, duhet të respektohen kërkesat strukturore të përcaktuara për seksionet e shërbimeve të pishinave të grupeve A1, A3 dhe A4.

Në pishinat e grupit B1 të vendosura në godina kompleks banimi të caktuara për t'u përdorur ekskluzivisht nga ata që qëndrojnë aty dhe të ftuarit e tyre, nuk janë të nevojshme dhomat e zhveshjes, as shërbimet higjienike në brendësi të impiantit të notit.

#### 2. Baseni i dezinfektimit të këmbëve të frekuentuesve

Qasja nga frekuentuesit e zonave të aktiviteteve të larjes duhet të jetë përmes një kalimi të detyrueshëm përgjatë të cilit është vendosur një basen për larjen e këmbëve me dush, i pashmangshëm, i ushqyer në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar zëvendësimin siç duhet me ujë që përmban një lëndë dezinfektante.

Një vaskë e tillë, e pajisur me dush, duhet të ketë përmasa dhe strukturë të tillë që të bëjë të detyrueshëm zhytjen e plotë të këmbëve, duke përfshirë dhe këpucët, në lëndën dezinfektante.

Për njerëzit me aftësi lëvizëse të reduktuara dhe/ose të dëmtuara duhet të parashikohet në hyrje një sistem i përshtatshëm pastrimi që siguron pastrimin dhe dezinfektimin e rrotave të pajisjeve ndihmëse që përdoren prej tyre për të lëvizur.

#### 5. Kutia e ndihmës së parë

Struktura duhet të pajiset me një kuti të ndihmës së parë dhe materialet e përshtatshme, të disponueshme dhe të përdorshme. Duhet të jetë e mundur afrimi i kollajshëm i mjeteve të ndihmës mjekësore.

#### SEKSIONI I IMPIANTEVE TEKNIKE

Të gjitha impiantet dhe aksesorët e tyre duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme nëpërmjet sinjaleve të posaçme që tregojnë funksionin e tyre; duhet të vendosen në dhoma të posaçme të mbyllura dhe të ajrosura mirë.

Lëndët kimike të përdorura për trajtimin e ujit duhet të ruhen në paketimin e tyre origjinal brenda dhomave të impianteve teknike. Administratori duhet të mbajë skedën teknike të lëndëve kimike të përdorura në dispozicion të autoriteteve kompetente inspektuese.

Në dhomat për impiantet teknike ku ka kontejnerë të lëndëve kimike duhet të parashikohen vende për magazinimin e tyre. Gjithashtu, impiantet termike nuk mund të instalohen në të njëjtin mjedis ku ndodhen impiantet teknike.

Lartësia minimale e këtyre dhomave duhet të jetë jo më e vogël se 2.4 m. Në rastin e impianteve ekzistuese dhe në pamundësi të përshtatjes së lartësisë së dhomave, duhet të sigurohet një shkëmbim i përshtatshëm i ajrit edhe me ndihmën e impianteve të ajrimit mekanik.

Impiantet teknike (pompat, filtrat, sistemi i dezinfektimit, aparaturat matëse, basenet e kompensimit), qarkullimi, ndërrimi i plotë i ujit në basen duhet të jenë në përputhje me normat në fuqi.

#### SEKSIONI I AKTIVITETEVE NDIHMËSE

Ku është parashikuar një seksion për shërbimet ndihmëse, si për shembull ato për aktivitete sportive të ndryshme nga ato të notit, hapësirat për freskim (bar, restorante etj.), hapësirat për aktivitetet argëtuese dhe kulturore, ky seksion duhet të jetë strukturuar në mënyrë të tillë që sektorët e përdorur nga frekuentuesit e këtyre zonave dhe nga ata të pishinës të jenë të veçuar.

#### SHTOJCA 10

#### MODEL RREGULLOREJE E BRENDSHME E PISHINËS

(Neni 16, pika 5 e rregullores)

1. Orari i funksionimit të pishinës është: (ditët e javës dhe ora e hapjes dhe e mbylljes).
2. Asnjë person nuk mund të përdorë pishinën, nëse pishina nuk është zyrtarisht e hapur dhe nëse kujdestarët nuk janë në detyrë.
3. Duhet të ndiqen të gjitha udhëzimet e dhëna nga kujdestarët.
4. Numri maksimal i përdoruesve është X persona në ditë.
5. Lejimi në pishinë mund të mohohet për ndonjë nga arsyet e mëposhtme.



- Helmin.
- Plagë të hapura, plagë, infeksione të lëkurës, rrrufe ose shkarkime të veshit.
- Çdo situatë ose provë, të cilat sipas mendimit të menaxherit do të rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e përdoruesve.
- 6. Para larjes në pishinë duhet bërë dush.
- 7. Duhet të vishen veshje të përshtatshme për not, si dhe kapuç noti.
- 8. Foshnjat/fëmijët e vegjël duhet të veshin pelena notimi poshtë rrobave të banjës. Ju lutemi mos përdorni pelena të zakonshme.
- 9. Fëmijët nën moshën 5-vjeçare ose jonotarët duhet të mbikëqyren nga një person përgjegjës, i cili qëndron në ujë dhe brenda largësisë së krahëve të fëmijës. Përdoruesit që nuk dinë të notojnë duhet të qëndrojnë në ujë me thellësi jo më lart se shpatullat e tyre.
- 10. Fëmijët më të vegjël se 14 vjeç duhet të shoqërohen nga persona madhorë.
- 11. Zhytja lejohet vetëm në fundet e thella dhe në pusët e zhytjes. Ju lutemi të vini re shenjat rreth anëve të pishinës!
- 12. Ndalohet vrapimi, shtyrja, ose çdo sjellje që shkakton çrregullime të panevojshme dhe që mund të rrezikojë ata vetë ose përdoruesit e tjerë.
- 13. Ndalohet pështymja, pastrimi i hundës në pishinë apo rreth saj, si dhe sjellje të pahijshme në publik.
- 14. Ndalohet pirja e duhanit!
- 15. Nuk lejohet konsumimi i ushqimeve dhe pijeve në pishinë.
- 16. Nuk duhet të laheni në pishinë në më pak se tre orë pas një vakt ushqimi.
- 17. Nuk lejohen enë qelqi ose objekte të thyeshme të çfarëdo lloji në zonën e pishinës ose WC-së.
- 18. Të gjitha lëndimet që ndodhin brenda zonës së pishinës ose WC-së duhet të raportohen menjëherë te përgjegjësi i pishinës.
- 19. Nuk lejohet asnjë kafshë brenda zonës së pishinës.
- 20. Nuk marrim asnjë përgjegjës për humbjen apo vjedhjen e sendeve personale. Sendet e mbetura në zonën e pishinës në fund të ditës do të vendosen në këndin e sendeve të gjetura.
- 21. Administratori i pishinës ose kujdestari mund të mbyllë ndonjë pjesë apo tërë kompleksin e pishinës për arsye sigurie apo të mirëmbajtjes.
- 22. Administratori i pishinës ose kujdestari ka autoritetin për të zbatuar këto rregulla dhe mund të largojë çdo përdorues që i shkel ato.

**VENDIM**  
**Nr.870, datë 14.12.2011**

**PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË PUNONJËSVE QË DËRGOHEN ME SHËRBIM JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Punonjësit e njërive të qeverisjes së përgjithshme që dërgohen me shërbim jashtë vendit, për të marrë pjesë në veprimtari të ndryshme ndërkombëtare, trajtohen financiarisht për përbalimin e shpenzimeve të shërbimit.
2. Trajtim financiar përfitojnë edhe punonjësit e përfaqësive tona jashtë vendit, kur emërohen, transferohen, dërgohen me shërbim jashtë përfaqësisë ose në një vend tjetër të huaj, si dhe kur kthehen në atdhe me shërbim.

3. Dërgimi me shërbim jashtë vendit bëhet me urdhër të titullarit të institucionit qendror, nga i cili varet njësia shpenzuese, ose të deleguarit të tij. Titullar institucioni qendror, në kuptim të këtij vendimi, është:

- a) Për njësitë e qeverisjes qendrore:
  - i) për ministrinë dhe çdo institucion të varësisë së saj është ministri ose i deleguari i tij;
  - ii) për aparatet e Presidencës, Kuvendit, Këshillit të Ministrave dhe institucionet në varësi të Kryeministrit, si dhe për entet kushtetuese, është Sekretari i Përgjithshëm përkatës;
  - iii) për punonjësit e institucioneve të tjera të pavarura, është titullari i institucionit;
  - iv) për punonjësit e gjykatës është kryetari i Gjykatës;
- b) Për njësitë e qeverisjes vendore, është kryetari njësisë vendore;
- c) Për fondet speciale, është titullari i fondit special.

4. Trajtimi financiar i punonjësve që dërgohen me shërbim në vendet e kontinentit evropian bëhet në euro, ndërsa për vendet e kontinenteve të tjera në USD (dollar amerikan). Trajtimi financiar përfshin:

- a) dietën ditore;
- b) shpenzimet e transportit;
- c) shpenzimet e fjetjes;
- ç) shpenzimet për pagesa të ndryshme.

5. Trajtimi financiar i punonjësve miratohet me urdhër të brendshëm shërbimi nga drejtuesi i institucionit, pas marrjes së autorizimit nga titullari i institucionit qendror, nga i cili varet njësia shpenzuese, i specifikuar sipas pikës 3 të këtij vendimi.

6. Masa e dietës ditore, sipas kategorive dhe funksioneve, paraqitet në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Për efekt të llogaritjes së dietave, dita e nisjes dhe e kthimit nga shërbimi konsiderohet si gjysmë (1/2) dite. Në rastet kur:

a) nisja bëhet përpara orës 8:00 dhe kthimi pas orës 20:00, dita përkatëse konsiderohet e plotë;

b) nisja dhe kthimi jashtë vendit bëhet brenda ditës, dita konsiderohet e plotë. Në këtë rast, nëse shihet e domosdoshme, mund të lejohet edhe rezervimi i një dhome hoteli, për qëllime të akomodimit të pjesshëm, por kjo gjithmonë e paracaktuar në urdhrin e titullarit të institucionit.

8. Në shpenzimet e transportit përfshihen:

a) shpenzimet e transportit vajtje-ardhje jashtë vendit;

b) shpenzimet e transportit nga aeroporti në destinacion dhe anasjelltas;

c) shpenzimet për lëvizjet në qytete të ndryshme, për nevoja pune, brenda shtetit përkatës, të cilat janë të përcaktuara paraprakisht në urdhrin e shërbimit.

Shpenzimet për transportin urban (metro, tramvaj, autobus etj.) përballohen nga vetë punonjësi.

9. Në shpenzimet e fjetjes përfshihet fatura e hotelit të përzgjedhur, si rregull, në mënyrë të diferencuar, për kategoritë sipas numrave rendorë të lidhjes nr.1, si më poshtë vijon:

a) për kategoritë 1, 2, 3-hotel deri me 5 yje;

b) për kategoritë 4, 5, 6-hotel deri me 4 yje;

c) për kategoritë 7, 8-hotel deri me 3 yje.

Në raste të veçanta, kur organizohen veprimtari ndërkombëtare, ku rezervimi bëhet nga organizatorët ose organizimi i veprimtarisë nuk lejon ndarjen e grupit në hotele të ndryshme, shpenzimet e fjetjes njihen sipas faturës përkatëse. Në rastet kur distanca nga hoteli në destinacionin ku kryhet veprimtaria, duke respektuar kategoritë e mësipërme, është e konsiderueshme, drejtuesi i institucionit miraton, në urdhrin e shërbimit, lëvizjen në kategoritë e mësipërme të hotelit (jo më shumë se një kategori). Çdo institucion nxjerr rregulla të brendshme për organizimin e punës për sigurimin e hoteleve me koston më të ulët.

10. Shpenzimet për pagesa të tjera përfshijnë pagesa që lidhen me udhëtimin jashtë vendit si: siguracion shëndetësor, viza, taksa, qira zyre etj. Telefonatat nga hoteli apo telefoni celular personal nuk mbulohen nga shpenzimet e institucionit, por nga vetë punonjësi.





11. Shpenzimet e transportit, të fjetjes dhe pagesat e tjera, në të gjitha rastet, njihen dhe paguhen sipas dokumentit përkatës justifikues (faturës, biletës etj.).

12. Trajtimi financiar i punonjësve, për mbulimin e shpenzimeve të përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi, përballohet nga fondet përkatëse të miratuara për çdo njësi të qeverisjes së përgjithshme. Në rastet kur këto shpenzime janë:

a) plotësisht në ngarkim të palës pritëse, punonjësit nuk trajtohen financiarisht nga buxheti i institucionit të tyre dhe nuk u detyrohen për asgjë këtij institucioni;

b) pjesërisht në ngarkim të palës pritëse, të cilat dokumentohen zyrtarisht nga pritësi, buxheti i institucionit përkatës përballon pjesën tjetër të shpenzimeve.

Në të gjitha rastet, nëse pritësi merr përsipër përballimin e shpenzimeve të ushqimit, në të holla ose mënyrë tjetër, dhe pavarësisht nga vlera e këtij shpenzimi, punonjësi nuk trajtohet me dietë.

13. Trajtim financiar përfitojnë punonjësit edhe kur dërgohen jashtë vendit për trajnime afatshkurtra, me urdhër të titullarit të institucionit qendror ose të deleguarit të tij, në rastet kur:

a) shpenzimet mbulohen tërësisht nga buxheti i shtetit. Në këte rast, masa e dietës, përllogaritet në masën 25 euro/USD në ditë;

b) shpenzimet mbulohen pjesërisht nga pala pritëse dhe në dokumentacionin e palës pritëse parashikohet shprehimisht mënyra e mbulimit të shpenzimeve. Në rastin kur pala pritëse nuk mbulon trajtimin me ushqim apo me të holla të punonjësit, Buxheti i Shtetit mbulon trajtimin financiar në masën 25 euro/USD në ditë.

14. Këto rregulla zbatohen edhe për entet publike jobuxhetore, ndërmarrjet shtetërore dhe shoqëritë tregtare me kapital mbi 50 për qind shtetëror.

15. Ngarkohet Ministri i Financave për nxjerrjen e udhëzimit për zbatimin e këtij vendimi.

16. Vendimi nr.304, datë 8.5.2003 i Këshillit të Ministrave “Për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimeve dhe për dietat për punonjësit e ministrive dhe të institucioneve buxhetore, kur dalin me shërbim jashtë shtetit”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

#### LIDHJA NR.1 MASA E DIETËS NË VALUTË TË HUAJ SIPAS KATEGORIVE

| Nr. | Kategoritë  | Në Euro/USD |
|-----|---|-------------|
| 1   | Presidenti i Republikës   | 120         |
| 2   | Kryeministri dhe Kryetari i Kuvendit  | 100         |
| 3   | Zëvendëskryeministri dhe nënkryetar i Kuvendit, ministrat dhe funksionarë të tjerë me pagë më të lartë apo që barazohen me ta në pagë   | 80          |
| 4   | Deputetët e Kuvendit dhe funksionarë të tjerë që barazohen me ta në pagë  | 70          |
| 5   | Zëvendësministrat, sekretarët e përgjithshëm në ministri dhe institucione të tjera qendrore dhe funksionarë të tjerë që barazohen me ta në pagë   | 60          |
| 6   | Ambasadorët, Konsulli i Përgjithshëm, të ngarkuarit me punë në shtete të huaja, Drejtorët e Përgjithshëm dhe drejtorët në Ministri dhe institucione të tjera qendrore dhe të gjitha funksionet e tjera që barazohen me ta në pagë | 50          |
| 7   | Diplomatët të tjerë në shtete të huaja, përgjegjës sektori dhe specialistë të ministrive, punonjësit e institucioneve në varësi të ministrive dhe institucioneve të tjera buxhetore.  | 40          |
| 8   | Punonjës mbështetës (teknikë, sekretarë, shoferë etj.)  | 35          |

Shënim. Koncepti pagë për efekt të këtij vendimi përfshin vetëm pagën për funksion (pagë grupi plus pozicioni ose shtesë funksioni) pagë për gradë apo klasë, pa përfshirë elementet e tjera të pagës, si: kushte pune, vështirësi, kualifikim etj.

**VENDIM**  
**Nr.28, datë 28.9.2011**

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR VENDOSJEN E TARIFAVE**

Në zbatim nenit 14 dhe nenit 22 pika 1 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar,  
Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

1. Të miratojë “Metodologjinë për vendosjen e tarifave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Vendimi i KKRR-së nr.32, datë 21.12.2009 “Për miratimin e metodikës mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, dhe vendimi i KKRR, nr.21, datë 19.5.2011 “Për një ndryshim në metodikën mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit të ujërave të ndotura”, shfuqizohen.
3. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.11.2011.

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**

**METODOLOGJIA PËR VENDOSJEN E TARIFAVE**

**HYRJE**

Uji është monopol natyror, si dhe një produkt jetik për njeriun. Për rrjedhojë, shërbimi i furnizimit me ujë duhet të trajtohet me shumë kujdes për sa u përket aspekteve rregullatore dhe tregtare. Komuniteti e përfiton këtë shërbim duke lejuar ofrimin e tij nga një operator i vetëm dhe, gjithashtu, duke evituar ndërtimin e sistemeve paralele. Ky sistem minimizon kostot, pasi konkurrenca në sektorin e këtij shërbimi kërkon investime të mëdha dhe të kushtueshme. Megjithatë, një monopol i parregulluar përbën rrezik potencial për konsumatorët, pasi mund të diktojë në treg nëpërmjet tarifave të larta dhe cilësisë së dobët të shërbimit. Pra, pa rregullimin e duhur, konsumatorët përballen me rënie të mirëqenies për shkak të uljes së cilësisë/sasisë së shërbimit. Çështjet e mjedisit kërkojnë, gjithashtu, vëmendje në rregullimin e sektorit të ujit. Shërbimet ujësjellës-kanalizime janë të rëndësishme nga ana sociale dhe gjithmonë nën vëzhgimin e publikut. Konsumatorët janë të interesuar të kenë furnizim me ujë në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe lidhje të rregullt me sistemin e kanalizimeve.

Në Shqipëri rregullimi i këtij monopoli natyror synon të sigurojë për konsumatorët që çmimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të jetë i arsyeshëm krahasuar me cilësinë e shërbimit. Përcaktimi i tarifave sipas kësaj metodologjie përfshin shqyrtimin e kostove, duke u caktuar objektiva operatorëve për t’u përmirësuar në të mirë të të gjithë shqiptarëve, duke strukturuar procesin e shqyrtimit të tarifave dhe së fundmi miratimin e tyre.

Enti Rregullator i Ujit (ERRU) në Shqipëri i kryen këto funksione të rëndësishme rregullatore në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, në përputhje me ligjin nr.8102, datë 28 mars 1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar.

Objektivi i ERRU-së në miratimin e tarifave UK dhe tarifave për shërbime të tjera është:

- të mbrojë konsumatorët nga tarifat monopol; dhe
- t’u bëjë të mundur të licencuarve të rikuperojnë kostot e arsyeshme të kryerjes së një shërbimi efektiv, duke përfshirë dhe mundësinë për të siguruar një fitim mbi investimin e tij, që është i mjaftueshëm për përmirësime dhe ndërtime të reja.



Objektivi i dytë është veçanërisht i rëndësishëm. Pjesa më e madhe e operatorëve në Shqipëri nuk janë ende në gjendje të mbulojnë kostot e tyre. Si rezultat, mbulimi së pari i kostove operative dhe mirëmbajtjes është objektiv i menjëhershëm, ndërsa mbulimi i kostove totale është objektiv për të ardhmen. ERRU synon të mbështesë në mënyrë graduale mbulimin e kostos totale në përputhje me direktivat e BE-së për ujin.

Gjithsesi, vetëm rritja e tarifave do të sillte më shumë të ardhura për operatorin, por kjo gjë do të kundërshtojë nga konsumatorët nëse menaxhimi dhe ofrimi i shërbimit mbeten jocalësorë. Për këtë arsye, ndryshimi i tarifave nga ERRU përfshin, si pjesë të këtij procesi, edhe analizën e progresit në përmirësimin e performancës teknike dhe financiare, e cila do të çojë në rritjen e mbulimit të kostove. Miratimi për rritjen e tarifave duhet të jetë i kushtëzuar vetëm për operatorët, që arrijnë të përmirësojnë performancën teknike dhe financiare.

Gjetja e balancës ndërmjet mbrojtjes së interesit të konsumatorëve në të njëjtën kohë me rritjen e qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit është objektiv kryesor i ERRU-së, ashtu siç parashikohet në vizionin dhe misionin e dhënë më poshtë:

Vizioni – një sektor ujësjellës-kanalizimesh financiarisht i vetëqëndrueshëm që ofron cilësi të lartë, si edhe shërbime të përballueshme për të gjithë konsumatorët në Shqipëri.

Misioni – sigurimi për të gjithë shqiptarët i ofrimit të cilësisë më të lartë të arritshme me një çmim të drejtë dhe në mënyrë financiarisht të qëndrueshme nga operatorët e shërbimit të ujësjellës-kanalizimeve.

## KREU 1

### BAZA LIGJORE, ZBATIMI I METODOLOGJISË, PËRKUFIZIMET

#### Neni 1

##### **Objekti dhe baza ligjore**

1. Kjo metodologji është miratuar nga komisioni dhe shërben si udhëzues “për të miratuar çmimet dhe tarifën e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, të shitjes me shumicë dhe pakicë, afatet kohore dhe standardet e shërbimit, të ofruara nga operatorët që sigurojnë këto shërbime” (ligji nr.8102, neni 14, 22).

2. Kjo metodologji është miratuar nga komisioni më 28 shtator 2011, sipas ligjit nr.8102, të ndryshuar, neni 14 (I, i).

#### Neni 2

##### **Zbatimi i metodologjisë**

1. Në zbatim të nenit 14 (I, b), në ligjin nr.8102, të ndryshuar, metodologjia për vendosjen e tarifave është e detyrueshme të zbatohet nga të gjithë operatorët UK dhe do të monitorohet nga ERRU-ja.

2. Operatorët propozojnë tarifën e shërbimeve që ofrojnë sipas llojit të konsumatorëve, në përputhje me strukturën e tarifës së përcaktuar në metodologji dhe të miratuar nga ERRU-ja, siç parashikohet në ligjin nr.8102, të ndryshuar, neni 14 (I, b).

#### Neni 3

##### **Përkufizime**

“Enti Rregullator i Ujit (ERRU)” është institucioni i pavarur që rregullon sektorin e furnizimit me ujë, të largimit dhe të përpunimit të ujërave të ndotura në përputhje me ligjin nr.8102 (të ndryshuar).

“Komisioni” është Komisioni Kombëtar Rregullator që udhëheq Entin Rregullator të Ujit që funksionon në bazë të ligjit nr.8102 (të ndryshuar).

“Konsumatorë” janë të gjitha kategoritë e përfituesve familjarë, publikë dhe privatë (të tanishëm dhe në të ardhmen) të cilët përdorin shërbimet e furnizimit me ujë dhe/ose kanalizimeve.

“Sistemi i furnizimit me ujë” përbëhet nga tërësia e elementeve, si: vepra e marrjes, sistemi i pompave, njësitë e dezinfektimit, rezervuarët, linjat e transmetimit dhe rrjeti shpërndarës.

“Sistemi i kanalizimeve” është sistemi që përbëhet nga tërësia e elementeve, si: linjat e shkarkimit/grumbullimit të ujërave të ndotura, linjat e largimit dhe/ose stacionet e pompimit të ujërave të ndotura, veprat e shkarkimit të tyre në trupat ujore pritëse, si dhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotur (nëse sistemi është i pajisur me to).

“Tarifë mesatare” është termi që vjen nga komponenti i ndryshueshëm i “tarifës me dy pjesë”. Ajo barazohet me tarifën variabël në qoftë se operatori do të aplikonte një tarifë të ndryshueshme të unifikuar (nuk ka dallim ndërmjet grupeve të konsumatorëve dhe nivelit të konsumit).

“Tarifë për shërbime të tjera” është termi i përdorur për të gjitha shërbimet e një operatori dhe nuk lidhet direkt me ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, por që duhet të paguhet nga konsumatori për shërbime shtesë.

“Mbulimi i plotë i kostos” do të thotë që kostot e operatorit për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime mbulohen plotësisht nga faturimet e shërbimeve të klientëve.

“Zona e juridiksionit” është zona, ku operatori i licencuar është përgjegjës të ofrojë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime<sup>1</sup>.

“Tarifa për nevojat bazë të konsumit”, gjithashtu e njohur me emrin “tarifa sociale do të thotë një tarifë, që është projektuar për të siguruar sasi minimale uji për nevojat jetike me një çmim veçanërisht të ulët për konsumatorët familjarë.

“Të ardhurat” nënkuptojnë çdo vlerë monetare të grumbulluar nga operatorët për shërbimet e ofruara në vitin për të cilin flasim. Gjithsesi, kur ERRU analizon nëse kostot janë mbuluar nga të ardhurat, kjo gjithmonë nënkupton që të ardhurat shtesë dhe subvencionet janë marrë në konsideratë.

“Operator” është subjekti i licencuar nga ERRU që ushtron aktivitetet e shërbimit të furnizimit me ujë, grumbullimit, largimit e trajtimit të ujërave të ndotura dhe ofron një ose disa nga këto shërbime sipas kategorive të përcaktuara në licencë. Në këtë metodologji, operatorët janë klasifikuar në operatorë “të mëdhenj” dhe “të vegjël” sipas kriterëve të mëposhtme.

Operatorë të mëdhenj do të quhen:

- Operatorët që kryejnë vetëm shërbimin e furnizimit me ujë, brenda zonës së tyre të shërbimit për më shumë se 100 000 banorë.

- Operatorët që kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në zonën e tyre të shërbimit për më shumë se 50 000 banorë.

- Operatorët që nuk bëjnë pjesë në grupet e mësipërme do të konsiderohen operatorë të vegjël.

“Sistemi i tarifave” nënkupton parametrat, kriteret dhe standardet e përdorura për përcaktimin e tarifës për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime për kategori të ndryshme konsumatorësh dhe nivele të ndryshme konsumi.

“Faktorët e strukturës së tarifës” i referohen peshës relative të tarifës së dhënë për njësinë e volumit të konsumit të ujit ndërmjet grupeve të ndryshme të konsumatorëve dhe niveleve të ndryshme të konsumit.

“Tarifë” është vlera e veçantë që vjen nga sistemi specifik i tarifave të operatorëve. Përdoret si për “tarifën aforfe” ose “tarifë me dy pjesë”. Paralelisht përdoret edhe termi “çmim”. Të dy termat “tarifë” dhe “çmim” përdoren lidhur me produktin kryesor të një operatori që ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

“Tarifa me dy pjesë” përbëhet nga komponenti i ndryshueshëm (variabël) dhe nga komponenti fiks i tarifës. Komponenti i ndryshueshëm përcaktohet si çmim/m<sup>3</sup>. Komponenti fiks i tarifës është një çmim fiks në vit ose në muaj. Tarifa me dy pjesë mund të aplikohet vetëm në rastet kur matësit janë të instaluar dhe lexohen. Përndryshe aplikohet një “tarifë aforfe”.

<sup>1</sup> Ashtu siç është parashikuar edhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.660, të datës 12.9.2007.



“Shërbimet UK” është tërësia e shërbimeve të kryera nga operatorët tek konsumatorët përmes sistemeve të furnizimit me ujë, si dhe sistemeve të grumbullimit, largimit dhe/ose trajtimit të ujërave të ndotura.

“Shitja e ujit me shumicë” është situata në të cilën uji shitet te një blerës nga një ose disa pika shpërndarjeje me qëllimin e rishitjes së tij për konsumatorët individualë brenda zonës së shërbimit të blerësit me shumicë.

## KREU 2

### SISTEMI I TARIFAVE TË SHËRBIMEVE UK DHE TARIFAT PËR SHËRBIME TË TJERA

#### Neni 4

#### **Objektivat e politikës së tarifave**

1. Operatorët zgjedhin strukturën e tarifave duke pasur parasysh realizimin e objektivave të politikës tarifore, si vijon:

a) Mbulimi i kostos: Struktura e përzgjedhur e tarifave duhet të sigurojë mbulimin e kostove të shërbimeve, nëpërmjet së cilës të ardhurat i tejkalojnë kostot. Operatorët duhet të rrisin nivelin e arkëtimit hap pas hapi, deri sa të arrihet mbulimi i plotë i kostove:

i) Të ardhurat mbulojnë kostot e plota operative dhe të mirëmbajtjes;

ii) Të ardhurat mbulojnë kostot operative dhe të mirëmbajtjes, si dhe amortizimin;

iii) Të ardhurat mbulojnë kostot operative dhe të mirëmbajtjes, amortizimin, si dhe tarifën e interesit mbi huat (nëse ka).

b) Efikasiteti menaxhues: Mbulimi i kostos duhet të arrihet përmes përpjekjeve sistematike për të ulur kostot e shërbimit duke rritur efikasitetin menaxhues dhe teknik; duke ulur humbjet e ujit në sistem; duke ulur lidhjet e paligjshme; dhe duke rritur të ardhurat nëpërmjet përmirësimit të normës së arkëtimit. Vlerësimi i arritjeve në përmirësimin e performancës teknike dhe financiare të operatorëve do të shqyrtohet nga ERRU përpara miratimit të ndryshimit të tarifave.

c) Përballueshmëria: Struktura e tarifave duhet të përcaktojë një tarifë të përballueshme për nevojat bazë të konsumit për konsumatorët me të ardhura të ulëta, veçanërisht për ato zona ku skemat e subvencioneve ende nuk janë përcaktuar. Në përputhje me standardet ndërkombëtare, shtresat me të ardhura të ulëta të popullsisë nuk duhet të paguajnë më shumë se 5% të të ardhurave të tyre për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime<sup>2</sup>.

d) Efikasiteti mjedisor: Struktura e tarifave duhet të përcaktojë tarifa më të larta, për konsumatorët me nivel të lartë konsumi me qëllim inkurajimin e ruajtjes së burimeve dhe një nivel konsumi të qëndrueshëm, duke pasur parasysh edhe çështjet mjedisore.

#### Neni 5

#### **Bazat e përcaktimit të tarifave**

1. Kategoritë e konsumatorëve janë:

a) familjarë;

b) publikë;

c) privatë.

2. Në rastet kur klientët janë të pajisur me matës, aplikohet tarifa me dy pjesë. Komponenti fikse në një tarifë me dy pjesë përgjithësisht mbulon kostot fikse. Kurse komponenti i ndryshueshëm përgjithësisht duhet të mbulojë kostot variabël.

<sup>2</sup> Shqipëria ka njohur zyrtarisht këto standarde të të drejtave të njeriut përmes bashkëpunimit të Rezolutës së Kombeve të Bashkuara (UN) “Mbi të drejtat e njeriut për ujë të pijshëm dhe kanalizime”, në Këshillin e të Drejtave të Njeriut në 24 mars 2011.

3. Në rastin kur një operator i furnizimit me ujë përballet me probleme që kanë të bëjnë me cilësinë ose me sasinë e ujit, komponenti volumetrik i tarifës mund të jetë më i lartë sesa vetëm kostot variabël. Një komponent i tillë mund të stimulojë konsumatorët për të kursyer ujin.

4. Në këndvështrim afatmesëm, kostot e shërbimit të furnizimit me ujë duhet të shpërndahen ndërmjet grupeve të ndryshme të konsumatorëve, veçanërisht në rastin kur nuk ekziston një skemë subvencionesh funksionale për familjet me të ardhura të ulëta. Komponenti volumetrik i tarifës do të rritet paralelisht me rritjen e konsumit.

5. Kostot për shërbimin e largimit e të përpunimit të ujërave të ndotura ndahen ndërmjet grupeve të ndryshme të konsumatorëve në bazë të volumit të ujit të konsumuar. Tarifatat do të ndjekin ritëm progresiv në varësi të volumit të konsumuar dhe të shkarkuar. Për ndotësit problematikë (që shkaktojnë ndotje të rënda)<sup>3</sup> do të vihet një tarifë shtesë për ujërat e ndotura. Komponenti fikse në përgjithësi mbulon kostot fikse.

#### Neni 6

##### **Llogaritja e kostove**

1. Kostot duhet të llogariten sipas sistemit kombëtar të kontabilitetit. Për periudha afatmesme, operatorët duhet t'i llogarisin kostot nga të dhënat e kostos historike për çdo element shërbimi të marrë nga sistemi i kostos akruale<sup>4</sup> dhe nga kosto në bazë të aktivitetit<sup>5</sup>.

2. Kostot fikse për leximin e matësve, faturimin, arkëtimin dhe shpenzimet administrative do të llogariten mbi bazën e kostove aktuale të secilit komponent. Kostot e përgjithshme për zyrat, administratën, shërbimet ligjore dhe personale do të përfshihen në kostot fikse.

3. Kostot e operimit dhe mirëmbajtjes (O&M) që lidhen me vëllimin e prodhimit dhe të shpërndarjes së ujit, si dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura llogariten nga kostot aktuale: energji elektrike, kimikate, inventarë, shpenzime për personelin, transport etj., për të ofruar këto shërbime të konsumatorët sipas standardeve të pranueshme.

4. Kostot për blerjen e ujit me shumicë janë të përfshira në tarifën për njësi të paguar nga operatori.

5. Amortizimi do të llogaritet çdo vit.

6. Interesi për huat e marra për të financuar investimet e reja do të përfshihet si kosto sipas normës së interesit të paguar.

7. Detajet do të jepen në udhëzimin për kontabilitetin e kostos, të miratuar nga ERRU.

#### Neni 7

##### **Struktura e tarifave dhe modeli i miratuar nga ERRU**

1. Struktura e tarifave përshkruan se si kosto të ndryshme të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve shpërndahen sipas kategorive të konsumatorëve. Ajo pasqyron se sa paguan (në total) secila kategori konsumatorësh për këto shërbime.

2. Struktura e tarifave mund të përdoret nga operatorët për hartimin e një strategjie për të vendosur një tarifë të përbalueshme për nevojat bazë të konsumit për familjet me të ardhura të ulëta, veçanërisht nëse nuk ekziston një skemë subvencionesh funksionale.

3. Për konsumatorët me matës, ERRU do të kërkojë aplikimin e “tarifës me dy pjesë” ku:

<sup>3</sup> Ndotës problematikë konsiderohen subjektet që shkaktojnë ndotje nga kryerja e proceseve kimike dhe teknologjike prodhimi.

<sup>4</sup> Kostot e një shërbimi në një periudhë të caktuar, por me likuidim të mëvonshëm.

<sup>5</sup> Kostot e llogaritura për çdo aktivitet (prodhim, shpërndarje, grumbullim, largim e përpunim të ujërave të ndotura).



a) Pjesa e tarifës që mbulon kostot fikse: kjo do t'i faturohet konsumatorit nëpërmjet një komponenti mujor "tarifë fikse".

b) Pjesa që mbulon kostot volumetrike (të konsumit): do t'i faturohet konsumatorit nëpërmjet një komponenti mujor "tarifë variabël".

Tarifa me dy pjesë ndihmon për të siguruar se operatori nuk i përcakton shumë poshtë ose shumë lart kostot fikse, nëse volumet e shitjes ose lidhjet e konsumatorëve të tij janë të ndryshme nga çfarë është parashikuar. Konsumi i ujit për të gjithë konsumatorët duhet të matet. Kur operatorët nuk e kanë arritur ende këtë objektiv, ata duhet të propozojnë një tarifë fikse mujore për konsumatorët pa matës (konsumatorët që nuk përdorin matës) dhe duhet të planifikojnë të kalojnë 100% në matje të konsumit.

4. Për konsumatorët pa matës duhet aplikuar një tarifë aforfe (konsumatorët paguajnë një tarife të caktuar pa specifikim volumetrik të konsumit. Kjo tarifë duhet të përcaktohet në nivel të tillë që të stimulojë konsumatorët të pajisen me matës.

5. Struktura e tarifave propozohet nga operatori dhe miratohet nga ERRU. Propozimi për ndryshimin e tarifave për periudhën e përcaktuar në aplikimin për ndryshimin e tarifave, duhet të pasqyrojë hapat e mëposhtëm:

a) Llogaritjen e të ardhurave që nevojiten për të arritur nivelin e mbulimit të kostos sipas miratimit nga ERRU-ja;

b) Vlerësimin e një "tarife për nevojat bazë të konsumit" për familjet me të ardhura të ulëta, në qoftë se është e aplikueshme;

c) Propozimin e strukturës tarifore për arritjen e objektivave të politikës tarifore, dhe përcaktimin e komponentëve fiks dhe variabël sipas llojit të konsumatorëve dhe në qoftë se kërkohet edhe niveleve të konsumit.

## Neni 8

### Rritja e tarifave bllok për konsumatorët me matës uji

1. ERRU inkurajon operatorët të propozojnë një tarifë bllok në rritje për konsumatorët me matës uji, ku aplikohen tarifa më të larta për konsumatorët që konsumojnë përtej volumit të kufirit minimal (për shembull 4.5 m<sup>3</sup>/muaj). Sipas "rritjes së tarifës bllok", tarifa për njësi për ujin e konsumuar duhet të jetë më e ulët për bllokun e parë të konsumit dhe në rritje për bllokun e dytë, dhe për blloqet e tjera pasuese, nëse do të ketë. Në mënyrë që të mënjanohej tarifat e padrejta, operatori duhet të ndajë lidhjet ekzistuese të përbashkëta. Lidhjet e përbashkëta duhet të zëvendësohen nga lidhje individuale me matës uji.

2. Në qoftë se operatorët kanë vendosur të aplikojnë strukturën e tarifës bllok, ERRU duhet t'u kërkojë operatorëve të propozojnë struktura tarifore për blloqet e konsumit për kategoritë e ndryshme të konsumatorëve. Tarifat për blloqet e ndryshme të konsumit në tri kategoritë e ndryshme të konsumatorëve duhet të jenë brenda kufijve të pranueshëm të faktorëve të strukturës së tarifave të dhëna më poshtë. Këto kufij për tarifat e mundshme janë përcaktuar duke marrë parasysh strukturat shumë të ndryshme të operatorëve.

Faktorët e strukturës së tarifave për blloqet të ndryshme të konsumit dhe kategori konsumatorësh

| Kategoria e konsumatorëve | Blloqet e strukturave të tarifave (metra kub/muaj) |              |              |               |
|---------------------------|--|--------------|--------------|---------------|
|                           | < 4.5  | 4.5 deri 20  | 20 deri 30   | > 30          |
| Familjarë                 | 1.0*   | 1.0 deri 3.0 | 1.5 deri 4.0 | 2.5 deri 6.0  |
| Publikë                   | 1.0 deri 2.0                                       | 1.0 deri 3.0 | 1.5 deri 5.0 | 2.5 deri 10.0 |
| Privatë                   | 1.0 deri 2.0                                       | 1.5 deri 4.0 | 2.0 deri 6.0 | 3.0 deri 12.0 |

\*faktorin = herë

Shembull. Për kategorinë e konsumatorëve familjarë, tarifa/m<sup>3</sup> ujë të konsumuar, për nivelet më të larta të konsumit mund të jetë deri në gjashtë herë më e madhe se tarifa në nivelet më të ulëta të konsumit. Po ashtu, për konsumatorët privatë/industrialë mund të ketë tarifë më të lartë se konsumatorët familjarë.

Rritja e tarifës bllok është veçanërisht e përshtatshme për zonat ku skema e subvencioneve për familjet në nevojë nuk është funksionale. Për konsum deri në 4.5 m<sup>3</sup> për familje/muaj, do të faturohet një përqindje më e ulët e tarifës mesatare.

3. Në qoftë se është zgjedhur aplikimi i një tarife bllok, operatori duhet të jetë i kujdesshëm të mos aplikojë tarifa të larta për një grup të caktuar konsumatorësh që i detyrojnë ata të gjejnë burime shtesë furnizimi ose të anulojnë kontratën. Në këtë rast mund të merret parasysh edhe tarifa me dy pjesë, e unifikuar.

#### Neni 9

### **Tarifa për shitje uji me shumicë**

1. Tarifa e shitjes së ujit me shumicë mbulon koston e shërbimit dhe një përfitim të mundshëm (maksimumi 5%). Përcaktimi i koston për këtë shërbim varet nga:

- vendndodhja e pikave të lidhjes në sistemin e furnizimit me ujë për shitjet me shumicë;
- lloji i shërbimit që ofrohet.

2. Operatori (shitësi) duhet t'i paraqesë ERRU-së marrëveshjen me blerësin. Nëse nevojiten ndryshime, ERRU informon operatorin dhe blerësin për to. Nëse ERRU nuk përgjigjet brenda 30 ditësh, palët e mësipërme mund ta konsiderojnë mospërgjigjen si miratim formal. Në çdo rast, ERRU duhet të miratojë tarifat e shitjes së ujit me shumicë.

#### Neni 10

### **Tarifa e shërbimit për grumbullimin, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura**

1. Kur operatori ofron si shërbimin e furnizimit me ujë, dhe atë të kanalizimeve, kostoja dhe të ardhurat e shërbimit të kanalizimeve duhet të llogariten veç nga kostoja dhe të ardhurat e shërbimit të furnizimit me ujë.

Kur operatori ofron si shërbimin e furnizimit me ujë dhe atë të kanalizimeve, kostot administrative dhe të përgjithshme ndahen ndërmjet të dyja shërbimeve në mënyrë proporcionale, në mënyrë që shumat e përgjithshme të mos ndryshojë.

Në periudhën afatmesme, subvencionimi i kryqëzuar i shërbimeve të kanalizimeve nga të ardhurat e shërbimit të furnizimit me ujë dhe anasjelltas duhet të evitohet.

2. Kostot e shërbimit për grumbullimin, largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura lidhen me sasinë e ujërave të ndotura të shkarkuara për çdo konsumator. Sasia e ujërave të ndotura do të merret 100% e sasisë së ujit të konsumuar.

Në rast se konsumatori furnizohet me ujë nga një pus ose nga burime të tjera, nevojitet matje shtesë. Në këtë rast, mund të vendoset një komponent fiks për kanalizimet krahas komponentit volumetrik.

3. Për konsumatorët që shkaktojnë ndotje problematike (të rënda), operatori mund të vendosë tarifa të posaçme (p.sh. mund të vendosen tarifa të veçanta për higjienën në terren). Ato duhet të mbulojnë kostot reale.

#### Neni 11

### **Tarifat për shërbime të tjera**

1. Operatorët kryejnë edhe disa shërbime të tjera, të cilat kanë koston e tyre që duhet të mbulohet nga konsumatorët. Lista e mëposhtme e tarifave të tjera nuk është e limituar, që do të thotë se mund të ketë dhe tarifa të tjera nëse është e nevojshme:





- Tarifë fikse për faturën;
- Tarifë lidhjeje;
- Tarifë rilidhjeje;
- Tarifë për instalimin e matësit;
- Tarifë për testimin e matësit.

2. Tarifë fikse për faturën është menduar të mbulojë koston e faturimit dhe leximit të matësit, mirëmbajtjes së lidhjes dhe testimit të matësit në intervale të rregullta (të paktën një herë në shtatë vjet). Tarifa fikse rekomandohet të përdoret edhe për të parandaluar aplikimin për disa lidhje nga i njëjti konsumator, në mënyrë që të përfitojnë disa herë nga blloku më i ulët i konsumit brenda një kategorie konsumi.

3. Tarifa e lidhjes vendoset vetëm kur sistemit i shtohet një klient i ri nëpërmjet një lidhjeje të vetme.

4. Tarifa e rilidhjes duhet të vendoset sa herë që një klient është shkëputur nga rrjeti për një arsye të justifikueshme (p.sh. për mospagimin e faturës). Tarifa duhet të jetë mjaftueshëm e lartë për të stimuluar konsumatorët që të paguajnë faturat në kohë.

5. Tarifa për instalimin e matësve aplikohet, kur një matës duhet të zëvendësohet për shkak të dëmtimit nga konsumatori, si dhe për instalimin e matësit në një lidhje të re ose ekzistuese.

6. Tarifa për testimin e matësit është tarifa për procesin e testimit të aparateve matëse të ujit. Testimi i matësit mund të iniciohet me kërkesë të konsumatorit ose të operatorit nëse konstatohen çrregullime. Tarifat për testimin e aparatit matës do të vendosen në bazë të kushteve të specifikuara në Kodin e Ujit.

7. Të gjitha tarifat e mësipërme duhet të përfshihen në propozimin për ndryshimin e tarifave. ERRU do të analizojë nëse tarifat për shërbimet e tjera janë të arsyeshme krahasuar me kostot e operatorit. Nëse gjykohet se tarifat nuk janë të arsyeshme, ERRU do të bëjë rekomandime për përmirësime të këshilli mbikëqyrës dhe operatori.

### KREU 3

## PROPOZIMI PËR NDRYSHIMIN E TARIFAVE, PROCESI I VENDOSJES SË TARIFAVE DHE MIRATIMI I TYRE

### Neni 12

#### Çështje të përgjithshme

1. Vetëm operatorët e licencuar mund të aplikojnë për miratim tarife.
2. Sipas ligjit nr.8102 (të ndryshuar), neni 22, pika 3: “Asnjë tarifë apo pjesë e saj nuk mund të modifikohet më shumë se një herë brenda vitit.”.
3. Ka një hapësirë kohore brenda vitit se kur mund të bëhet aplikimi për tarifë. Operatorët paraqesin pranë ERRU-së propozimin për ndryshimin e tarifave, pasi të kenë përfunduar bilancin vjetor. Gjithashtu, propozimi për ndryshim tarife kërkon informacion për të gjitha subvencionet që do të përfitohen për periudhën në vijim.
4. Aplikimet për ndryshim tarife për vitin pasues paraqiten pranë ERRU-së brenda gjashtëmujorit të parë të vitit aktual. ERRU nuk i shkel këto afate kohore: çdo propozim i paraqitur, pasi ka kaluar afati, duhet të riparaqitet me shifra të aktualizuara në vitin e ardhshëm. Është mirë që operatorët t’i paraqesin propozimet e tyre sa më herët të jetë e mundur.
5. E njëjta procedurë ndiqet edhe nëse ERRU përcakton afate kohore individuale për qartësim ose informacionin që mungon dhe operatori nuk i respekton afatet kohore ose nëse operatori nuk arrin të transferojë tarifën rregullatore në llogarinë e ERRU-së sipas afatit të përcaktuar në kontratën e mëparshme.

6. Një operator mund të aplikojë për tarifa të reja jo vetëm për një vit, por edhe për një interval kohor 2-5 vjet, nëse ka një plan biznesi afatmesëm për periudhën e kërkuar. Në këtë rast, skema e tarifave do të parashikojë një ndryshim progresiv gradual vjetor të tarifës për periudhën në shqyrtim me qëllim shmangien e rritjeve të mëdha. Ky ndryshim gradual mund të përdoret për të mbuluar ndikimet e inflacionit.

7. Nëse një operator vendos të aplikojë për një rritje graduale tarifash, ai duhet të hartojë një plan biznesi duke dhënë shifrat kryesore të parashikuara për periudhat përkatëse sipas udhëzimit të ERRU-së.

8. Në bazë të planit të biznesit, ERRU është në gjendje të vendosë mbi ndryshimin gradual të tarifave, mbështetur në treguesit kryesorë të performancës të vendosur me operatorin. Rritja e tarifave lejohet vetëm me parakushtin që operatori të arrijë objektivat e performancës. Tarifat, gjithashtu mund të ndryshohen dhe për vitin e dytë dhe/ose të tretë duke marrë parasysh diferencën ndërmjet subvencioneve të parashikuara dhe atyre të marra aktualisht për periudhën në shqyrtim.

9. Zakonisht, operatori fillon procedurën e aplikimit për ndryshimin e tarifave, por edhe ERRU, kur e gjykon të arsyeshme, mund t'i sugjerojë një operatori të aplikojë për tarifa të reja.

10. Operatorët e vegjël që administrojnë sisteme të vogla të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve operojnë në një kontekst të veçantë dhe përballen me disa sfida specifike. Për këtë arsye, ERRU do të nxjerrë një udhëzim të veçantë të kësaj metodologjie për të specifikuar tiparet e veçanta të procesit të ndryshimit të tarifave për këta operatorë.

### Neni 13

#### **Pagesa rregullatore**

1. Pagesa rregullatore është detyrim vjetor për t'u paguar nga operatorët. Operatorët duhet të kenë shlyer pagesën rregullatore përpara aplikimit për ndryshim tarife.

2. Pagesa rregullatore përllëgaritet mbi të ardhurat vjetore të parashikuara nga aktiviteti dhe do të jetë e ndryshme:

a) për operatorët që mbulojnë deri në 50% të kostos totale;


b) për operatorët që mbulojnë më shumë se 50% të kostos totale.

Çdo vit në muajin shtator, Komisioni Kombëtar Rregullator do të vendosë dhe do të publikojë përqindjen e pagesës rregullatore (për secilin grup) që do të aplikohet për vitin në vazhdim.

### Neni 14

#### **Procesi i miratimit të tarifave**

1. Procesi i aplikimit dhe miratimit të tarifave ndjek hapat e mëposhtëm:



2. Përpara paraqitjes së propozimit për ndryshim tarife tek ERRU, operatorët e mëdhenj<sup>6</sup> duhet të organizojnë një seancë dëgjimore me publikun. Qëllimi i kësaj seance është që operatori të kontaktojë me konsumatorët, duke i informuar ata rreth zhvillimeve kryesore dhe arsyes për aplikimin për ndryshim tarife. Kjo seancë dëgjimore rekomandohet edhe për operatorët më të vegjël. ERRU njoftohet për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe i dërgohet një kopje e mendimit të konsumatorëve sipas procesverbalit të mbajtur në takim.

3. Në situata të jashtëzakonshme (siç mund të jetë rritja e çmimeve, inflacioni), që ndikojnë në mënyrë të atillë duke rritur koston totale me më shumë se 15% dhe në kushtet kur operatori duhet t'i mbulojë vetë këto kosto, operatori duhet t'i kërkojë ERRU-së për rilogaritje dhe përshtatje të tarifës.

#### Neni 15

### Dokumentacioni i aplikimit

1. Propozimi për ndryshim tarife duhet të përfshijë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Bilancin dhe pasqyrat financiare të vitit të fundit të cilit i referohemi (në rast se nuk e kanë dorëzuar përpara aplikimit siç kërkohet nga ERRU);
- Mendimin e njërive të qeverisjes vendore për tarifën e propozuar<sup>7</sup>;
- Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës (në rastin e operatorëve sh.a.);
- Për operatorët e mëdhenj procesverbali i seancave dëgjimore me publikun;
- Subvencionet<sup>8</sup>, të cilat operatori do t'i marrë për periudhën gjatë së cilës do të aplikohen tarifën e propozuar;
- Raport i detajuar për gjendjen teknike dhe ekonomike të operatorit;

<sup>6</sup> Operatorët e mëdhenj përcaktohen si më poshtë:

- Operatorët që ofrojnë vetëm shërbimin e furnizimit me ujë për një popullsi prej 100 000 banorësh në zonën e tij të shërbimit;
- Operatorët që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime për një popullsi prej 50 000 banorësh në zonën e tij të shërbimit.

<sup>7</sup> ERRU kërkon që operatori të paraqesë edhe opinionin e njërive të qeverisjes vendore të zonës së shërbimit, ku të përfaqësohet të paktën 50% e opinionit të konsumatorëve.

<sup>8</sup> Operatorët duhet të deklarojnë shumën e subvencioneve të marra në vitin e kaluar, si dhe shumën e parashikuar për t'u marrë gjatë vitit aktual nga Buxheti i Shtetit. ERRU do të marrë në konsideratë gjatë procesit të miratimit të tarifave subvencionin e marrë, si dhe parashikimin e subvencionit për vitin e ardhshëm.

- Vendimi i miratimit të Kodit të Ujit nga asambleja dhe operatori.
- 2. Mungesa e një prej dokumenteve të sipërpërmendura bën që propozimi për ndryshim tarife të mos shqyrtohet nga ERRU.
- 3. Raporti i detajuar për gjendjen teknike dhe ekonomike i sipërpërmendur duhet të përmbajë:
  - a) Për sistemet e furnizimit me ujë:
    - Një analizë të gjendjes aktuale të të gjitha elementeve përbërëse të tij (burimet e ujit/vepra e marrjes, stacionet e pompimit, rezervuarët e ujit, njësitë e dezinfektimit/pastrimit të ujit, linjat e dërgimit dhe rrjetet shpërndarëse);
    - Informacion për problemet kryesore të sistemit në lidhje me operimin dhe mirëmbajtjen, humbjet e ujit, lidhjet e paligjshme, matjet;
    - Informacion për problemet kryesore në lidhje me cilësinë e ujit të shërbyer;
    - Informacion për investimet e kryera në tri vitet e fundit ose që nga periudha e aprovimit të fundit të tarifave duke dhënë edhe objektet kryesore ku janë bërë këto investime si dhe rezultatet që janë arritur në përmirësimin e shërbimit;
    - Informacion për strukturën organizative të operatorit dhe për numrin e punonjësve të shoqëruar edhe me shpjegimet përkatëse;
    - Informacion i detajuar në lidhje me zonën e shërbimit dhe popullsinë që banon në të, konsumatorëve që u shërbehet, të dhënat e regjistrit të konsumatorit;
    - Informacion në lidhje me plotësimin e kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.23, datë 9.1.2008 “Për tarifën e përdorimit të ujit”;
    - Informacion në lidhje me efikasitetin e energjisë.
  - b) Për sistemet e kanalizimeve:
    - Një analizë të gjendjes aktuale të të gjitha elementeve përbërëse të tij (linjat e shkarkimit/grumbullimit të ujërave të ndotura, stacionet e pompimit, veprat e shkarkimit të ujërave të ndotura në trupat ujorë pritës, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura);
    - Informacion për problemet kryesore të sistemit në lidhje me operimin dhe mirëmbajtjen;
    - Informacion për investimet e kryera në tri vitet e fundit ose që nga periudha e aprovimit të fundit të tarifave, duke dhënë edhe objektet kryesore ku janë bërë këto investime, si dhe rezultatet që janë arritur në përmirësimin e shërbimit;
    - Informacion për strukturën organizative të operatorit dhe për numrin e punonjësve të shoqëruar edhe me shpjegimet përkatëse;
    - Informacion i detajuar në lidhje me zonën e shërbimit dhe popullsinë që banon në të, konsumatorëve që u shërbehet, të dhënat e regjistrit të konsumatorit;
    - Informacion i detajuar teknik në lidhje me impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura (nëse kanë), duke përfshirë të dhëna për procesin, kapacitetin, efikasitetin e energjisë.
- 4. ERRU mund të përdorë të dhënat e grumbulluara për operatorët nga njësitë e monitorimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve në varësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit. Këto të dhëna do të përdoren gjithashtu nga ERRU për të analizuar nëse janë plotësuar objektivat e performancës që u janë caktuar operatorëve nga ERRU.
- 5. ERRU, në bazë të ligjit nr.8102 (të ndryshuar), mund të kryejë inspektime për të verifikuar të dhënat e paraqitura nga operatori.


#### Neni 16

#### Vlerësimi i propozimit për ndryshim tarife – vështrim i përgjithshëm

1. Analiza e propozimit të tarifave kryhet sipas strukturës në skemën e mëposhtme. Kjo analizë fillon me shqyrtimin e “Kostot e parashikuara të operimit dhe mirëmbajtjes” dhe të treguesve të performancës të paraqitura nga operatori. Zbriten kostot e papranueshme dhe korrigjohen treguesit e performancës mbi bazën e analizës së tyre. Rezultati është “Kostot e ndryshuara të performancës të



O&M” dhe “treguesit e ndryshuar të performancës”, të cilat ERRU i njih për të përcaktuar tarifën mesatare. Kategoritë e ndryshme të tarifave rrjedhin nga tarifa mesatare, duke marrë parasysh vëllim/mënyrën e faturimit. Skema e mëposhtme jep vetëm një ide të përgjithshme, ndërsa detajet shpjegohen në nenet në vazhdim.



#### Neni 17

#### Vlerësimi i propozimit për ndryshim tarife – analiza e kostos

1. ERRU propozon për shpenzimet O&M “të arsyeshme dhe të nevojshme” për ofrimin e shërbimeve efçente. ERRU analizon kosto të veçanta të operatorit. Kjo bëhet për të siguruar që konsumatorët të paguajnë vetëm kosto të justifikuara.

2. ERRU jo vetëm i analizon kostot e operatorit, por edhe i krahason ato me kostot e operatorëve të tjerë të ngjashëm. Arsyet e uljeve duhet të shpjegohen qartë. Nëse shpjegimet e dhëna nga operatori nuk justifikojnë nivelin e rritjes së shpenzimeve, ERRU propozon ulje të kostove të parashikuara.

3. Në raste të caktuara, ERRU mund “të përshpejtojë” procesin e aplikimit për tarifa. “Përshpejtimi” do të thotë se ERRU do të thjeshtojë këtë proces dhe ushtron më pak kontroll mbi zëra specifikë të shpenzimeve. Operatorët që kanë të drejtë të jenë objekt i shqyrtimit të shpejtë, mund të jenë operatorët me skema të vogla shërbimi dhe operatorët që i plotësojnë ose i tejkalojnë objektivat e performancës. “Përshpejtimi” është kompetencë e ERRU-së.

Neni 18

**Vlerësimi për propozim ndryshimi tarife – analiza e performancës**

1. Analiza e performancës përqendrohet në tregues të caktuar për të përcaktuar nëse ka devijime nga performanca për të cilën është rënë dakord. Këto tregues janë:

1. uji pa të ardhura (humbjet);
2. niveli i matjes;
3. cilësia e ujit;
4. kohëzgjatja e furnizimit me ujë (orët e shërbimit);
5. përdorimi efikas i energjisë;
6. efikasiteti i stafit (stafi/1,000 lidhje);
7. mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë;
8. mbulimi me shërbimin e kanalizimeve;
9. perceptimi i rregullatorit<sup>9</sup>;
10. përpjekje dhe masa të veçanta për përmirësimin e efikasitetit, shërbimit ose performancës;
11. norma e arkëtimit<sup>10</sup>.

2. Për treguesit 1-9 dhe 11, operatorët përcaktojnë tregues të ndryshëm krahasimi. Treguesi 10 është tregues cilësor, me anë të të cilit operatori mund të “shpërblehet” për iniciativat e veçanta që tregojnë angazhimin e tyre për performancë të mirë.

3. Tabela më poshtë tregon mënyrën se si llogaritet vlerësimi i performancës:

| <b>Pikët sipas objektivave</b>  | <b>Min</b>  | <b>Max</b>  |
|---|-------------|-------------|
| 1) Uji pa të ardhura (humbjet)  | -20         | +10         |
| 2) Niveli i matjes  | -20         | +10         |
| 3) Cilësia e ujit   | -15         | +7.5        |
| 4) Kohëzgjatja e furnizimit me ujë (orët e shërbimit)   | -15         | +7.5        |
| 6) Efikasiteti i përdorimit të energjisë  | -20         | +10         |
| 5) Efikasiteti i stafit (stafi/1,000 lidhje)  | -20         | +10         |
| 7) Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë   | -15         | +7.5        |
| 8) Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve  | -15         | +7.5        |
| 9) Perceptimi për rregullatorin   | -10         | +5          |
| Shuma e pikëve  | -150        | +75         |
| Bonusi  |             |             |
| 10) Përpjekje dhe masa të veçanta për përmirësimin e efikasitetit, shërbimit ose performancës | 0           | +75         |
| <b>Totali i përgjithshëm i pikëve</b>   | <b>-150</b> | <b>+150</b> |

4. Mosrealizimi nga një operator i treguesve dhe standardeve të përcaktuara (treguesit 1-9) ka ndikim negativ dhe do të çojë në një ulje të vlerësimit të performancës. Në rast se operatori i arrin objektivat e caktuar për këta tregues, nuk do të ketë as ulje, dhe as bonus, por 0 pikë.

5. Në rastin kur operatori i tejkalon objektivat për treguesit 1-9, do të jepet një bonus pikësh. Pikët bonus do të jepen sipas shkallës së tejkalimit të objektivave (deri në maksimumin e shumës së treguar në tabelë).

6. ERRU do të marrë në konsideratë akordimin e një bonusi shtesë për përpjekje të jashtëzakonshme dhe iniciativave për të përmirësuar eficientë, shërbimin apo furnizimin me ujë (treguesi 10). Arsyeja për dhënien e një bonusi të veçantë ndërmjet 1-75 pikëve do të përcaktohet në vendimin e komisionit (paraprak dhe final).

<sup>9</sup> Objektivi i performancës (Perceptimi i rregullatorit) do të vlerësohet në mënyrë transparente, që do të përfshijë elemente, si koha e reagimit dhe përgjigja e operatorëve ndaj kërkesave të ERRU-së, likuidimin në kohë të pagesave rregullatore etj.

<sup>10</sup> Objektivi 11 (Norma e arkëtimit) do të përdoret në nenin 19.



7. Rezultati i përgjithshëm më pas transformohet në të dhëna monetare si përqindje e kostove të ndryshuara (shih nenin 18). Shpërblimi/penalizimi maksimal shkon deri në +/- 5% të kostove të ndryshuara për operatorët e tipit I (kostot e O&M-së nuk janë mbuluar ende) dhe +/- 10% të kostove të ndryshuara për tipin II të operatorëve (> se 100% mbulim i kostove O&M). Tabela më poshtë tregon shumat ekzakte sipas performancës:

| <b>Rezultati i përgjithshëm*</b> | <b>Performanca, ndryshimi tipi I</b> | <b>Performanca, ndryshimi tipi II</b> |
|----------------------------------|--------------------------------------|---------------------------------------|
| 150                              | 5%                                   | 10%                                   |
| 140                              | 4,67%                                | 9,33%                                 |
| 130                              | 4,33%                                | 8,67%                                 |
| 120                              | 4,00%                                | 8,00%                                 |
| 110                              | 3,67%                                | 7,33%                                 |
| 100                              | 3,33%                                | 6,67%                                 |
| 90                               | 3,00%                                | 6,00%                                 |
| 80                               | 2,67%                                | 5,33%                                 |
| 70                               | 2,33%                                | 4,67%                                 |
| 60                               | 2,00%                                | 4,00%                                 |
| 50                               | 1,67%                                | 3,33%                                 |
| 40                               | 1,33%                                | 2,67%                                 |
| 30                               | 1,00%                                | 2,00%                                 |
| 20                               | 0,67%                                | 1,33%                                 |
| 10                               | 0,33%                                | 0,67%                                 |
| 0                                | 0,00%                                | 0,00%                                 |
| -10                              | -0,33%                               | -0,67%                                |
| -20                              | -0,67%                               | -1,33%                                |
| -30                              | -1,00%                               | -2,00%                                |
| -40                              | -1,33%                               | -2,67%                                |
| -50                              | -1,67%                               | -3,33%                                |
| -60                              | -2,00%                               | -4,00%                                |
| -70                              | -2,33%                               | -4,67%                                |
| -80                              | -2,67%                               | -5,33%                                |
| -90                              | -3,00%                               | -6,00%                                |
| -100                             | -3,33%                               | -6,67%                                |
| -110                             | -3,67%                               | -7,33%                                |
| -120                             | -4,00%                               | -8,00%                                |
| -130                             | -4,33%                               | -8,67%                                |
| -140                             | -4,67%                               | -9,33%                                |
| -150                             | -5,00%                               | -10,00%                               |

\*Rezultati i përgjithshëm rrumbullakohet në dhjetëshen e sipërme ose të poshtme.

Kostot e ndryshuara të ponderuara të performancës përmbajnë penalitetet/shpërblimet, si dhe ndryshimet për kostot e pajustificuara. Kostot e ndryshuara të ponderuara të performancës së operimit dhe mirëmbajtjes janë kostot që ERRU u lejon operatorëve t'i marrin parasysh. Nëse operatori nuk punon mirë, ai do të haset me një deficit. Në të kundërt, ai do të ketë përfitim.

Neni 19

**Vlerësimi i propozimit për ndryshim tarife – tarifa mesatare**

1. Në llogaritjen e tarifës mesatare merret parasysh kriteri i efikasitetit “norma e arkëtimit” (11). Duke aplikuar parametrat e rëna dakord për çdo kriter në llogaritje siç jepet më poshtë, operatorët penalizohen automatikisht nëse nuk i arrijnë objektivat e përcaktuar ose do të shpërblehen në qoftë se i tejkalojnë ato.

2. Llogaritjet e mëposhtme tregojnë si nxirret tarifa mesatare (duke përfshirë normën e arkëtimit):

|  |
|--|
| Kostot e ndryshuara të performancës                    |
| / Sasia e parashikuar për faturim (në m <sup>3</sup> ) |
| = Kostoja mesatare e parashikuar (për m <sup>3</sup> ) |

|  |
|--|
| Kostoja mesatare e parashikuar (për m <sup>3</sup> ) = Tarifa mesatare e parashikuar (për m <sup>3</sup> ) |
|--|

3. Norma e arkëtimit dhe përcaktimi i tarifës mesatare. Ndërsa ekuacioni “Kostoja mesatare e parashikuar (për m<sup>3</sup>) = tarifa mesatare e parashikuar (për m<sup>3</sup>)” është përgjithësisht detyruese, nënkupton që norma e arkëtimit është 100%. Gjithsesi, pranohet se pjesa më e madhe e operatorëve nuk do të jetë në gjendje të mbledhin 100% të shumës së faturuar. Do të përcaktohen stimuj me qëllim rritjen e vazhdueshme të normës së arkëtimit.

Si rezultat, treguesit e mëposhtëm të krahasimit do të përcaktohen duke marrë parasysh nivelet aktuale të çdo operatori individual. Më pas, ky tregues përdoret për të llogaritur tarifën mesatare të ndryshuar, duke përfshirë dhe normën e arkëtimit.

Shembull. Nëse tarifa mesatare e parashikuar (duke përjashtuar normën e arkëtimit) është 100 ALL dhe norma e arkëtimit sipas *benchmarking* është 85%, tarifa mesatare do të jetë:

$$100/(85/100) = 100/0,85 = 117,65 \text{ ALL.}$$

Neni 20

**Vlerësimi i propozimit për ndryshim tarife – veçoritë për aplikimin e parë**

1. Gjatë vitit të parë të zbatimit të kësaj metodologjie, pranimi i propozimeve për ndryshim tarife është deri më 31 nëntor 2011. Organizimi i një seance dëgjimore nuk do të kërkohet për vitin 2011, por për operatorët e mëdhenj kjo do të jetë e detyrueshme duke filluar nga viti 2012.

2. Këtë herë, ndryshimi i tarifës do të bëhet vetëm për një vit.

3. Për propozimin e parë, për ndryshimin e tarifës sipas kësaj metodologjie do të bëhet vetëm analiza e kostos. Më tej, ERRU do të përcaktojë një grup treguesish bazë performance për çdo operator, të cilët do të vlerësohen gjatë ndryshimeve të tarifave në periudhat në vazhdim.

KREU 4

**ZBATIMI DHE MONITORIMI I TARIFAVE**

Neni 21

**Zbatimi i tarifave**

1. Operatori i njofton konsumatorët një muaj më parë për rritjen e tarifës. Operatori i njofton konsumatorët duke bërë njoftime në shtypin apo mediat lokale, duke përfshirë një shënim dhe në faturën e ujit të konsumatorit. Operatori, brenda orarit zyrtar të punës, vë në dispozicion të konsumatorëve dokumentacionin për tarifën aktuale. Operatori, publikon në vende të ndryshme ku ka akses publiku, vendimin për ndryshimin e tarifave, por duke mos u kufizuar vetëm në, pikat ose zyrat e tij të marrëdhënieve me konsumatorin.





## Neni 22

### **Monitorimi i zbatimit të tarifave**

1. ERRU monitoron zbatimin korrekt të tarifave siç përshkruhet në këtë metodologji. Nëse ERRU konstaton se operatori zbaton një tarifë që është mbi tarifën e ndryshuar e të miratuar prej saj, do të zbatojë dënimet për kundërvajtje të përcaktuara në nenin 32/1, pika b të ligjit nr.8102 (të ndryshuar). Në rast se operatori ka vënë tarifë më të lartë për konsumatorët, ai do të korrigojë tarifën në ciklin pasues të faturimit dhe do të rimbursojë shumën e vënë mbi tarifën e rregullt të miratuar nga ERRU për çdo konsumator të prekur nga aplikimi i parregullt i tarifës së ndryshuar të miratuar.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 4.1.2012  
Doli nga shtypi më 4.1.2012

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 1700 copë | Formati: 61x86/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja Mediaprint  
Tiranë, 2012

Çmimi 52 lekë